



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.11.2021, ora 10:00

Drejtton mbledhjen:

Klotilda Bushka– kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”.
2. Seancë dëgjimore me institucionet e mëposhtme:

Autoritetin për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Inspektorin e Lartë të Drejtësisë

SPAK-un

Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Oerd Bylykbashi, Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Gerta Duraku, Dhurata Tyli, Erisa Xhixho, Gazmend Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Elda Hoti dhe Gledis Çeliku,

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Fatmir Xhafaj, Jurgis Çyrbja, Toni Gogu, Bledion Nallbati, , Ermonela Valikaj(Felaj) dhe Saimir Hasalla.

Të ftuar:

Gentjana Sula - Kryetare e Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Simon Mirakaj – Anëtar i Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Skënder Vrioni - Sekretar i Përgjithshëm i Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Vitori Fuqi - Përgjegjëse i Sektorit të Financave i Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Mirela Lame - Përgjegjëse e Sektorit Juridik i Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Erta Borici - Sekretare e Kryetares së Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Alfred Balla – Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Sander Beci - Kryetar i Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Buxhetit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Emis Cerava- Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Dëshira Pasko- Sekretar i Përgjithshëm në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë

Isida Koka- Këshilltare në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë

Arben Kraja – Drejtues i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krijimit të Organizuar

Mariel Frroku – Drejtori i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financës në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Pranvera Strakosha - Komisionere për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Arbana Basha- Drejtoreshë e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes në Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Ollga Hodaj- Drejtoreshë e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse në Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Mimoza Dhembli – Drejtoreshë e Përgjithshme, Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës

Vilma Causholli- Përgjegjëse Sektorit të Analizës Buxhetore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës

Fran Brahimi – Drejtor i Drejtorisë së Financave Vendore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës

HAPET MBLEDHJA

Klotilda Bushka- Mirëdita, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me rendin e ditës sipas njoftimit përkatës.

Vijojmë shqyrtimin e projektligjin e buxhetit 2022 dhe ë rendin e ditës sot kemi planifikuar seancat dëgjimore me disa institucione. Besoj se kjo është seanca e fundit me dëgjesat e institucioneve. Institucionet janë: Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; Këshilli i Lartë i Prokurorisë; Inspektori i Lartë i Drejtësisë; Prokuroria e Posaçme; Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil.

Fillojmë me dëgjesën e parë. Është paraqitur për Autoritetin për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zonja Gentjana Sula, kryetare e Autoritetit, mirë se erdhët zonja Sula; zoti Simon Mirakaj, anëtari Autoritetit, Skender Vrioni, sekretari Përgjithshëm, Vitori Fuqi, përgjegjëse e Sektorit të Financave, Mirela Lame, përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe zonja Erta Boriçi, sekretare e Kryetares së Autoritetit. Mirë se erdhët zonja Lame dhe zonja Boriçi!

Nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës kanë konfirmuar pjesëmarrjen zonja Mimoza Dhëmbi, drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit, zonja Vilma Çausholli, përgjegjëse e Sektorit të Analizës Buxhetor.

Zonja Sula, sot në këtë dëgjesë jeni ftuar për të dhënë mendimet tuaja nëse nevojat e institucionit mbulohen nga projektbuxheti dhe nëse ju keni diçka për të ndarë me komisionin përgjegjës. Ne jemi komision për dhënie mendimi sa i takon ligjit për buxhetin e vitit 2022, por në vijim të dëgjesave ky komision shqyrton edhe nevojat e institucioneve dhe më pas i sugjeron komisionit përgjegjës, që është Komisioni i Ekonomisë, nëse duhen adresuar çështje të caktuara. Theksin e vëmë te prioritizimi i nevojave. Në këto kushte, fjala është për ju.

Faleminderit!

Gentjana Sula- Faleminderit, zonja kryetare e komisionit!

Së pari, do ta filloj fjalën time për një falënderim të përgjithshëm për komisionin, sepse edhe më parë edhe tani e kemi ndjerë mbështetjen dhe bëj thirrje edhe për një mbështetje më të madhe për shkak se projekti është akoma i ri dhe ka akoma nevojë për t'u zgjeruar dhe për t'u plotësuar!

Meqenëse folët për prioritetet, kryefjala e kësaj dëgjese ka të bëjë me detyrat shtesë që parlamenti i ka dhënë Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Detyrat shtesë burojnë së pari nga ndryshimet ligjore që janë bërë në majin korrik të vitit 2019 që lidhet me dy fusha: fusha e parë ka të bëjë me trajtimin e të vdekurve dhe të zhdukurve gjatë komunizmit është futur përkufizimi, roli i Autoritetit si palë për të qartësuar fatin e të zhdukurve për të sqaruar vendndodhjen dhe për t'u lidhur me institucionet ligjzbatuese dhe pushtetin vendor për të referuar rastet, për të shkëmbyer informacion dhe për të bërë mundur identifikim dhe rikuperim të personave. Për të këtë arsye ne kemi kërkuar dy herë pranë komisioneve parlamentare një strukturë shtesë prej 9 vetash, sepse është një punë shumë voluminoze, është një punë që nuk është bërë për një kohët ë gjatë, sepse është komplekse, por tani që institucioni është krijuar ne përballemi në mënyrë të vazhdueshme me kërkesa të personave familjarë, shoqatave, sidomos aplikime të personave familjarë, ku ka disa dhjetëra kërkesa. Ne kemi identifikuar vendndodhjen në një hark me 75 vende vendvarrimesh, kemi bërë shumë punë, por, natyrisht, kemi nevojë për strukturën shtesë.

Puna tjetër shtesë lidhet edhe me rezolutën, edhe me ligjin që na kërkohet të zgjerojmë aktivitetin në funksion të edukimit qytetar, sidomos me brezat e rinj, në mënyrë që ato gjëra që studiohen të përçohen në mënyrën e duhur te grupmoshat e reja. Kjo është e thjeshtë për t'u thënë, por duhet të kuptojmë që janë 500 mijë nxënës nëpër shkolla të grupmoshave të ndryshme që punojnë me mësues, nuk mjafton një marrëveshje që ne e kemi bërë me Ministrinë e Arsimit dhe një gatishmëri nga të gjitha krahët që kemi gjetur, qoftë në pushtetin vendor, qoftë në nivele të universiteteve, kanë nevojë për aktivitetet që ne i kemi sjellë, pra, atë çfarë ne kemi menduar, për të cilat kërkohet mbështetje.

Më konkretisht, ne jemi një institucion që kemi realizuar. Realizimi i pritshëm për vitin 2021 është paraqitur në dokumentin tuaj dhe është 90%. Duhet thënë që ka qenë një periudhë me emergjencë të forta, qoftë nga tërmeti, ku disa nga objektet tona u dëmtuan, sepse janë objekte shumë të amortizuara, qoftë nga COVID-i, ku ne kishim punë pikërisht me moshën e tretë që vjen dhe aplikon, kemi qenë të prekur nga kjo situatë, por, gjithsesi, kemi një realizim të pritshëm prej 90%.

Për sa i përket godinës, ne kemi marrë një financim të huaj nga qeveria suedeze. Për fat të mirë, ne po bëjmë transferimin nga ambientet ku jemi në ambientet e reja, që është rreth 3000 metër katror, ku fusim të gjithë arkivën dhe administratën. Për fat të mirë qeveria suedeze financoi rindërtimin e godinës dhe përgatitjen e kushteve, por, natyrisht, nuk është në gjendje dhe nuk do, dhe e kanë thënë, nuk janë të gatshëm të financojnë mjetet minimale si: tryeza, mjete zyrash dhe kompjuterët, të cilat mbeten për qeverinë.

Për shkak të dy emergjencave civile ne kemi rinegociuar aftin e projektit me qeverinë suedeze, e cila ka përfutur një shtesë deri në muajin korrik të vitit të ardhshëm. Besoj se kanë

ndodhur dy procese në të njëjtën kohë dhe, ndërkohë që ne kemi shtyrë projektin, Ministria e Financave ka bërë plan buxhetin dhe për këtë arsye nuk pasqyrohet financimi i huaj për vitin tjetër. Kështu që komenti i parë që kemi është që plani i financimit të huaj, pra që janë fonde nga qeveria suedeze për rikonstruktim, shërbime etik dhe krijimi i arkivës moderne, që është softwari që po blejmë tani, duhet të pasqyrohet në buxhetin e vitit 2022, ku bëhet fjalë për 67,2 milionë lekë, që besoj se kolegët e Ministrisë së Financave bien dakord se ky është një korigjim për shkak të shtesës së projektit në afat. E dyta ka të bëjë me TVSH-në që buron nga ky projekt, që është 10 milionë lekë.

Komenti i dytë ka të bëjë me fondin shtesë për blerjet e pajisjeve kompjuterike dhe pajisje zyre. Siç ju thashë, sistemin e blen donatori, godinën po e rindërtojmë me fonde donatori, por për pajisje zyre dhe kompjuterë me 10 milionë lekë që na janë dhënë është e pamundura që të realizohen. Kemi 60 veta dhe duhet thënë që kompjuterët e parë, si zyrë e re, i kemi marrë me kapitale nga zyrat që mbylleshin, të cilat kanë qenë të amortizuara dhe me ato kemi punuar, por tani, me godinën e re, ku zgjerohemi me 3 mijë metra, dhe arkiva dhe zyrat kanë nevojë për mjete. Ne nuk kërkojmë mjete luksi, por mjete optimale që të punojmë. Nga 1 milionë që është dhënë, ne kërkojmë të shtohet në 10 milionë, i cili është një fond minimal që është dhënë edhe për zyrat të tjera të ngjashme.

Fondi i tretë ka të bëjë me shpenzimet operative. Unë ju kam vënë përpara një listë se si e kemi menduar ne shpenzimin operativ. Ai është gjithmonë në funksion të detyrave shtesë. Me zyrat e reja ka nevojë të krijohet një ambient i mirë për studiuesit, ka nevojë të krijohet një fond i posaçëm për trajtimin e rasteve të zhdukjeve me forcë që kemi konstatuar, për disa punime të rilevimit të terrenit me gjeoradarë ka kompani të specializuara, të cilat duhen kontraktuar, e treta është numë realizimi i arkivës, *dataentry* dhe skanim dokumentesh që plotëson softwarin që po bëjmë. Njëkohësisht, është edhe lista e madhe me aktivitetet që ne kemi sjellë, të cilat kanë të bëjnë me konferenca shkencore, ekspozita, dialog lokal me bashkitë, me të cilat ne kemi filluar dhe kemi një eksperiencë të mirë, trajtimi i profileve biografike të së majtës dhe të djathtës, të klerit, të grave, trajtimi i vendeve të vuajtjes së dënimit, ku disa nga kolegët kanë sjellë disa shembuj sesi punojmë, por jemi të gatshëm edhe t'ju mirëpresim në fondin te zyrat e reja. Bëhet fjalë për 29 milionë lekë shtesë që kërkojmë për fond operativ.

Kërkesa e katërt, e thashë edhe në fillim, me shtesat e detyrave në ligj, ka lindur nevoja e një strukture shtesë, parlamentit i është kërkuar dy herë me shkresë, ke kemi bërë specifikimet dhe konsultimet me Ministrinë e Financave dhe me DAP-in dhe ua kemi paraqitur. Edhe aty kërkohet një shtesë fondi për 9 veta personel prej 11 milionë lekësh në vit. Mendojmë se përfshirja e këtyre kërkesave do të jetë në të mirë të punës.

Dua t'ju them edhe një herë që projektet e kujtesës kanë shumë punë, por kanë edhe impakt të madh në publik, sepse, përveçse rehabilitojnë viktimat, përveçse bëjnë një lustracion moral për rolin e gjithsecilit nga qytetarët e këtij shteti, kanë edhe një të mirë të madhe, promovojnë vlerat e demokracisë dhe të qytetarisë. Vetë koncepti i edukimit qytetar ka brenda edukimin politik për demokraci, vlerat qytetare në kolektiv, pra, është projekt i mirë që duhet thënë se edhe kushton. Këto kisha.

Klotilda Bushka- Faleminderit, zonja Sula!

Është e vërtetë, në fakt, sepse me ndryshimet e fundit ligjore juve ju janë shtuar funksione shtesë dhe kjo duhet adresuar sa i takon pjesës së strukturës për kryerjen e nevojave, gjithsesi, duke qenë se Ministria e Financave është pjesë e dëgjësës për t'iu përgjigjur nevojave tuaja dhe zoti Alqi Bllako është relator, unë do të doja të dëgjoja kolegët, pra, nga Ministria e Financave zonjën Çausholli, më pas zotin Bllako, pastaj kolegët e komisionit që kanë kërkuar fjalën.

Zonja Çausholli, fjala për ju.

Vilma Çausholli- Autoriteti i Dosjeve është një institucion shumë i rëndësishëm, që është ndjekur hap pas hapi dhe jemi mundura ta mbështesim me fonde financiare këtë institucion. Duke bërë një krahasim nga viti 2017 dhe në projektbuxhetin e vitit 2022, kemi një trefishim të burimeve njerëzore dhe financiare të këtij institucion, pra, kemi filluar me 20 punonjës dhe me një fond prej 31 milion dhe sot jemi në një strukturë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, atë po them, që nga viti 2017 kemi një shtim gradual në burimet njerëzore, të shoqëruara edhe me burime financiare.

Në vitin 2022 kemi arritur ta plotësojmë strukturën e miratuar më herët nga Kuvendi me 60 persona, janë akomoduar fondet e nevojshme në shpenzimet e personelit për 60 persona, si dhe shpenzimet normale operative të institucionit. Ne i njohim kërkesat dhe kemi pasur kontakte të vazhdueshme me institucionin që na i ka prezantuar këto kërkesa, por në buxhetin e vitit 2022 kemi mbajtur, pak a shumë, të njëjtat burime financiare me rritje të lehtë që shoqëron vetëm rritjen e personelit dhe nuk kemi akomoduar shtesa të tjera të institucionit, duke parë edhe mundësitë buxhetore, duke menduar që sapo u fut struktura e plotë prej 60 vetash të mund të shikohet ecuria.

Në lidhje me financimin e huaj, sigurisht që shprehemi dakord për një zhvendosje dhe një përllogaritje tjetër në vitin 2022, i cili nuk është përdorur në vitin 2021, e shoqëruar kjo qoftë me fondin e TVSH-së, që është i domosdoshëm për t'u parashikuar në vitin 2022.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zoti Bllako!

Alqi Bllako –Faleminderit, zonja kryetare!

Atëherë, për sa i përket buxhetit të institucionit të Autoritetit të Dosjeve, zonja kryetare përmendi një planifikim realizueshmërie për vitin 2021, i cili ishte në nivelin 90%. Ndërkohë që realizimi faktik, të paktën nga të dhënat që ne kemi nga thesari për 9-mujorin e parë, rezulton në masën 42%. Nuk e diskutoj fare që mund të jenë angazhime të marra në proces, të cilat do të likuidohen deri në fund të vitit, por ftoj institucionin që ta ndjekë në vazhdimësi këtë proces, pasi realizimi vazhdon të jetë më pak se gjysma.

Për sa i përket strukturës, ka pasur një vendim të vitit 2018 për miratimin e strukturës, ku parashikohej shtimi i numrit të punonjësve me 10 persona çdo vit. Ky plotësim është mbyllur në vitin 2021 dhe kemi kaluar nga 20-30 në 60 punonjës sot. Nëse do të duhet të miratohet një fond shtesë pagash, paraprakisht duhet të ketë një vendim për një shtesë në strukturë. Pra, duhet miratuar fillimisht vendimi për shtesën e strukturës, më pas të bëhet parashikueshmëria për shtesën e fondit të pagave.

Për sa i përket planifikimit për financimin e huaj, zonja Causholli e tha që ky është detyrim ligjor. Ka një shtyrje të afatit të zbatueshmërisë së marrëveshjes për vitin 2022, kështu që rrjedhimisht edhe fondi duhet të transferohet për atë vit dhe, për sa kohë transferohet fondi për financimin e huaj, pa diskutim që duhet shoqëruar edhe me vlerën respektive të TVSH-së, e cila ishte në vlerën 10,1 milionë dhe nuk ka asnjë dyshim që do të mbështet nga komision dhe do të reflektohet nga Ministria e Financave. Ndërkohë që institucioni lëviz në një godinë të re të financuar të ambasada suedeze. Është jonormale që Ministria e Financave të mos mbështesë operativitetin ditor të këtij institucioni, pra nuk mund të shkosh në një godinë të re dhe të mos kesh asnjë kompjuter laptop apo mobilie. Kështu që mendoj se, në këtë prizëm, kërkesa e institucionit është e arsyeshme dhe duhet mbështetur. Pa diskutim fakti që ne u mundësojmë ambiente të reja, komode për të ushtruar funksionin e tyre duhet shoqëruar edhe me mjetet logjistike të punës.

Për sa i përket zërit “602”, ku institucioni ka paraqitur një tërësi kërkesash për aktivitete të parashikuara, mendoj se në parim kërkesa është e mirëpritur. Duke parë realizueshmërinë e këtij zëri për vitin 2021, mendoj se vlera në tërësi është paksa e ekzagjeruar. Unë do të isha për të mbështetur një shtesë në shtesën “602”, por jo në vlerën e kërkuar. Do të më duhet pak më shumë kohë të shkojë zë më zë tek aktivitetet për të parë cilat janë aktivitetet më prioritare dhe për të rivlerësuar me Ministrinë e Financave se sa mund të ishte një shtesë e arsyeshme në këtë zë buxhetor.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Bllako!

Në fakt, është e vërtetë që Autoriteti ka paraqitur kërkesë për strukturë shtesë, në kuadër të ndryshimeve ligjore, për funksionet që janë shtuar, kryesisht për trajtimin e të vdekurve dhe të zhdukurve. Në fakt, herën e parë nuk premtoi koha, sepse ishte në përfundim të legjislaturës, tani ka ardhur e njëjta kërkesa për strukturën dhe ne do ta adresojmë në këtë komision. Po unë kam një pyetje për Ministrinë e Financave: nëse ne do ta miratojmë strukturën e re shtesë në personel për funksione të shtuara dhe nëse nuk e parashikojmë këtu në buxhet këtë shtesë, a mund më pas të realizohet marrja e personelit?

Vilma Causholli– Teknikisht nuk mund të miratohet, sepse numri i miratuar i punonjësve duhet të jetë i pasqyruar në mënyrë të plotë, sepse hidhet në sistemin e Thesarit dhe asnjë numër i shtuar nuk mund të paguhet përtej atij numri që ka sistemi i Thesarit. Pra, nëse sot është miratuar me 60 persona, në sistemin e thesarit pagesa do të jetë vetëm për 60 persona. Nuk mund të jetë për 60 plus 1, 2, 3 e më tutje. Kështu që, nëse miratohet struktura, duhet detyrimisht të miratohet njëkohësisht edhe shtesa e numrit të punonjësve. Më pas shpenzimet e personelit është një çështje që edhe mund të diskutohet, sepse jo që në muajin janar mund të merret personeli. Duke parë edhe shpenzimet faktike gjatë vitit të institucionit, mund të bëhen rialokime, por numri është i domosdoshëm të përfshihet.

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Kjo është një çështje teknike që na takon ne si komision ta zgjidhim dhe mendoj se ne si komision do të gjejmë një zgjidhje para se të kalojë buxheti në tërësi dhe ta trajtojmë edhe çështjen e strukturës që të japim mundësi edhe Ministrisë së Financave ta reflektojmë në buxhetin e këtij viti, sepse është një çështje që është në përgjegjësinë tonë. Ashtu siç e thashë, është e detyrueshme nga ndryshimet ligjore që kanë ndodhur. Nuk është se po kërkohet një shtesë në kuadër të vendimeve të mëparshme. Edhe shtesa prej 10 personash çdo vit ka qenë një zgjidhje e dakordësuar në atë kohë me Autoritetin që, me shtimin e funksioneve të para që kishte, pra pa ndryshimet ligjore, të bëhej gradualisht për efekt të ecurisë së punës në atë lloj forme.

Për sa i përket pjesës së pajisjeve, besoj se jemi dakord të gjithë me relatorin. Pra, bëjini një saktësitë gjësë dhe patjetër që, kur kemi mbështetje nga donatorët dhe marrim një ndihmë të konsiderueshme për një godinë, nuk është normale që të mos e plotësojmë institucionin me mjete pune. Kështu që ky është një detyrim ynë dhe patjetër duhet ta adresojmë. Pjesën e aktiviteteve besoj se e qartësuat së bashku dhe në këtë pikë unë po e ndërpres. Ndërkohë që e ka kërkuar fjalën zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, unë e kuptoj vërtet edhe zellin e Ministrisë së Financave. Tek e fundit është një pjesë e burokracisë administrative dhe do të mbajë atë qëndrim, pa i kërkuar asgjë më tepër se sa çfarë tha, por do të ishte e udhës që në çështje delikate, siç është kjo që po diskutojmë tani, në fakt, të gjitha çështjet e buxhetit janë delikate, do të ishte mirë që të ishte përfaqësuesi politik, ministri. Pse e them këtë?! Se unë e kuptoj që çështja e miratimit të buxhetit apo e diskutimit të buxhetit në komisionet e Kuvendit futet edhe një farë rutine, ku institucionet kërkojnë, Ministria e Financave bën sikur nuk do t'ju japë, relatori mundohet, dhe ky është një film i parë, pothuajse u bënë 30 vjet tashmë, ndërkohë që nuk duhet të jetë kështu, së paku për disa nga funksionet e shtetit. Cilat janë këto funksione?! Për shembull, funksionet që ushtron ky autoritet, funksioni që ushtron Instituti i Studimeve të Komunizmit. Një shtet mund të bëjë edhe pa këto funksione dhe pa këto institucione, siç ka bërë për një kohë të gjatë, por ishte nevoja e publikut shqiptar, e shoqërisë shqiptare, për t'i ngritur këto funksione nën formën e autoriteteve dhe për t'ia dhënë këtë shërbim shoqërisë shqiptare. Ajo që thotë kryetarja e komisionit është e vërtetë; kanë ndodhur ndryshime ligjore, duhet t'i buxhetosh. I është vendosur detyrë shtesë me rezolutën e këtij viti autoritetit, detyra shtesë duhet të japësh para, por ka diçka më të madhe që i tejkalon edhe ndryshimet ligjore, edhe detyrat shtesë në rezolutë: nevoja e shoqërisë shqiptare për të pasur kujtesë; ky është dallimi, esenca, substanca e procesit psikologjik të dekomunistizimit të shoqërisë shqiptare. Kjo është arsyeja pse zvarritemi në tranzicion pafund 30 vjet, nuk dimë ku janë varret pa emër, ku janë të zhdukurit. Ecim mbi këtë truall, mbi eshtra njerëzish të fajshëm që nuk u dihet emri se ku janë. Edhe këtu në komision ka njerëz që kanë ende të afërm të tyre, paraardhës të tyre, që nuk u dinë varrin. Kjo është një çështje dramatike për një shoqëri që nuk përfundon dot tranzicionin. Për këtë arsye një Autoritet, si ky i Dosjeve, me një veprimtari fillimisht të brishtë, por që tashmë ka fituar një celebritet edhe për seriozitetin, është shndërruar në pikë reference në shërbimet që jep, si një pikë që saktëson në njëfarë mënyre edhe moralitetin e shtetit apo të funksionarëve shqiptarë. E dini fare mirë, kushdo shqiptar që emërohet rishtas, duhet të trokasë te këta: është spiun, nuk është spiun. Në fakt, kjo është një çështje shumë e rëndësishme, ngelet ende si një makth i së shkuarës së shoqërisë shqiptare. Do të duhet ta kalojë këtë katarsis shoqëria shqiptare, por që ta bëjë këtë, do të duhen ndihmuar ata me buxhet.

Për këtë arsye, po flas edhe në emër të pjesës sonë, ne i japim mbështetjen maksimale çfarëdolloj demarshi për të ndihmuar Autoritetin ta kryejë sa më mirë funksionet që ka, ato ligjore rishtazi, por edhe ato që i janë vendosur me rezolutë.

Prandaj them që ka ca funksione, të cilat ky shtet do të duhet t'i marrë përsipër dhe të mos zvarritet nëpër labirintet e vogla, teknikalitetet: 5 lekë këtu, 7 lekë atje. Jo, sepse është

nevojë ulëritëse që i gjithë mentaliteti për dekomunistizimin e shoqërisë shqiptare të ndodhte një orë e më parë. Jemi të vonuar. 30 vjet dhe vazhdon ende ideja: kush është spiun, kush nuk është spiun. Ku janë varret? Ku nuk janë varret? Ku është gjyshi? Ku është daja? Bredhin ende për të gjetur prokurorin e kohës që ka qenë ai që ka dhënë urdhër, të togës së pushkatimit për t'i vrarë buzë lumit, eshtrat i merrte lumi dhe i çonte në det. Këto janë plagë të shoqërisë shqiptare.

Për këtë arsye, me ligj, ju është miratuar një kompetencë e shtuar. Një orë e më parë do të duhet të kenë strukturën e tyre shtesë, të buxhetohet, të fillojë nga puna. Dhe jo vetëm të fillojë nga puna, por, ndërkohë, do të duhet të bëjmë edhe diçka tjetër të nevojshme (në fakt, kaloi ajo puna e Prokurorisë së Përgjithshme), se kam dëgjuar që ka edhe një ngërç lidhur me çështjen e gjetjes së eshtrave, që prokuroria shqiptare bëhet pengesë, nuk jep leje ose nuk fillon procedimin disiplinor, duke u bërë pengesë pastaj edhe për zhvarrosjen apo gjetjen e eshtrave të të vrarëve dhe të të zhdukurve. E ky është makabritet!

Reforma e re në drejtësi? Çfarë njerëzish janë këta? Eshtra e gjetur nën dhë është prova e parë për të filluar procedimin penal. Dhe nuk është se janë vrarë apo janë zhdukur rastësisht, ka qenë një sistem diktatorial që e ka bërë këtë, me plan.

Kështu që kjo është ajo se çfarë duhet të bëjmë ne si pjesë e Komisionit të Ligjeve, pra jo vetëm mbështetje financiare, por, me të drejtë, edhe kontroll për masën, cilësinë e përdorimit të këtij buxheti, sepse është jo vetëm nevojë e parlamentit, por është nevojë e shoqërisë shqiptare.

Shumë mirë, të gjitha këto do të hidhen. Dikur nuk kanë qenë...

Keni përgëzimet, të paktën personale, të miat ju, Instituti i Studimit të Krimeve të Komunizmit, sepse njëri nga elementet është ndërgjegjësimi. Heqja e pluhurit të harresës, në fakt, makthet dalin natën, ankthet dalin natën dhe kjo është një gjë e mirë, ndërgjegjësimi, edukimi i brezit të ri. Kjo është, si të thuash, të shohësh nga e ardhmja. Duhet ta bëni, por është po kaq e rëndësishme, madje më e rëndësishme, të shohësh pak edhe nga e shkuara. Është pikërisht ajo çfarë thashë pak më parë: eshtrat e atyre që janë vrarë dhe janë zhdukur nuk do të gjejnë qetësi, por të paktën ne të gjallët e kësaj bote të bëjmë atë se çfarë kemi detyrim moral, mbi të gjitha.

Kështu që, zonja kryetare, nga ne keni mbështetjen maksimale në kërkesat që zonja, në emër të Autoritetit, ka bërë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Është e vërtetë, në fakt, që rëndësia e institucionit ka qenë e shtuar. Puna që ka kryer edhe në raportet vjetore të vetë Autoritetit është vlerësuar së tepërmi. Ky komision e ka mbështetur Autoritetin jo vetëm duke e dëgjuar, por edhe duke bërë vizita në terren për të parë nga afër kushtet e punës, po edhe në vijim të vizitave janë marrë masa se si duhet ndihmuar Autoriteti që t'i kryejë më mirë funksionet e veta, sepse ndajmë të njëjtin qëndrim besoj që, patjetër, këto institucione të kujtesës duhet ta bëjnë sa më mirë punën e tyre, në mënyrë që edhe brezat të kenë të qartë historinë dhe në brezat e rinj të ketë të vërteta, të cilat, në fakt, i duhen shoqërisë për t'u ndërgjegjësuar që situata si këto të mos kthehen më.

Nga ana tjetër, Autoriteti ka qenë pjesë aktive edhe në aktivitete të përbashkëta me Kuvendin jo vetëm në mbështetje financiare, por edhe në tema specifike për të treguar, pra, që jo vetëm Autoriteti ka punuar shumë mirë (dhe ne e kemi thënë këtë në të gjitha rastet kur kemi pasur aktivitete të përbashkëta apo punë në komision në lidhje me Autoritetin), por besoj që edhe Kuvendi e ka mbështetur dhe e ka bërë të qartë qëndrimin që ka.

Ndaj më vjen mirë që jemi të gjithë me të njëjtin vullnet dhe qëndrim që jo vetëm funksionet shtesë që i janë dhënë me ligj duhen mbështetur me fonde, por edhe detyrimet që keni nga rezoluta duhet patjetër të adresohen. Për këtë çështje të rëndësishme, që zoti Alibeaj ngriti sa i takon bashkëpunimit me prokurorinë, nëse unë nuk gaboj, edhe në rezolutën e vitit të kaluar të Kuvendit për Autoritetin është vendosur një thirrje për Prokurorinë e Përgjithshme që të kryejë detyrat e saj për të bashkëpunuar me Autoritetin, sepse për Kuvendin trajtimi i të vdekurve, i të zhdukurve dhe çdo procedurë lidhur me ta në të cilat prokuroria ka për të kryer funksionin, duhet zbatuar menjëherë sapo të jetë e mundur, përndryshe do të zbatohen sanksionet.

Kështu që më vjen mirë që jemi të gjithë në një qëllim për këtë.

Në fund do të bëjmë një përmbledhje të mënyrës se si ne do t'i adresojmë, por le t'ua japim fjalën edhe kolegëve që e kanë kërkuar: zotit Mediu, zonjës Bardeli dhe zonjës Çupi.

Zoti Mediu, fjala për ju.

Fatmir Mediu – Faleminderit!

Unë dua ta falënderoj Autoritetin e Dosjeve për punën e mirë që ka bërë dhe, domethënë, kërkoj si të gjithë kolegët të mbështesim maksimalisht kërkesat që ato parashtrajnë, por dua të parashtroj edhe disa çështje të tjera që kanë të bëjnë me punën tuaj!

E para, pajtohem tërësisht me faktin që ne duhet të kemi kujtesë dhe duhet ta ndërtojmë këtë kujtesë historike, sepse është pjesë e një historie jashtëzakonisht të dhimbshme të shoqërisë shqiptare për diktaturën komuniste, por duhet edhe të plotësojmë detyrimet që kemi edhe si anëtarë të institucioneve ndërkombëtare.

Këshilli i Europës u ka kërkuar të gjitha vendeve anëtare të miratojnë rezolutën për dënimin e krimeve të komunizmit dhe mendoj se është detyrë e këtij Kuvendi për ta miratuar këtë rezolutë jo vetëm thjesht në qasjen politike të problemit, por sidomos në përcaktimet e detyrimeve të qeverisë për ta nxjerrë në dritë të gjithë këtë histori dhe për t'iu dhënë Autoritetit të Dosjeve apo edhe institucioneve të tjera të gjithë mundësinë dhe kapacitetet njerëzore dhe financiare që të kryejnë punën e tyre.

U përmend këtu një fakt jashtëzakonisht i dhimbshëm për sa u përket viktimave që nuk u gjenden eshtrat. Të mos harrojmë që familjarët e tyre në pjesën më të madhe kanë ndërruar jetë, domethënë pjesa e atyre që kanë vuajtur nëpër burgje, por të paktën ne si klasë politike, si shoqëri, t'u japim mundësinë familjeve të tyre që të kenë mundësi t'i varrosin, t'i respektojnë sipas traditës që ne kemi, këto viktima të komunizmit. Janë rreth 5000 burra, rreth 500 gra, që janë ekzekutuar nga sistemi komunist dhe një pjesë të madhe të tyre nuk u gjenden eshtrat. Dhe siç u tha këtu, edhe kur i gjejnë, edhe vetë familjarët apo edhe me ndihmën e Autoritetit, janë në pamundësi për të bërë atë që duhet, siç është një rast në Shkodër, që më thonë, sepse duhet pa dyshim marrëdhënia me autoritetet lokale, por edhe me prokurorinë, por, pavarësisht se ne kemi vendosur një rezolutë, nuk janë marrëdhënie të tilla që të fillojnë dhe të funksionojnë në një kohë të shpejtë.

Është shumë e dhimbshme për këta familjarë që të mos bëjnë dot të mundur, domethënë që të kenë mundësi të respektojnë atë pjesë të familjes së tyre që ka bërë një nga historitë, do të thosha, më kurajoze nga pikëpamja njerëzore kundër diktaturës komuniste. Kjo është njëra anë, që, patjetër, do të duhet të gjejë zgjidhje dhe ndoshta në këtë rezolutë, që është jashtëzakonisht e vonuar për ta miratuar, parlamenti shqiptar duhet të përcaktojë edhe këto detyrime.

Po ashtu, unë do të sugjeroja, është e rëndësishme, që këtë pjesë të historisë jo vetëm të mos e lëmë në harresë, por duhet ta bëjmë pjesë të historisë botërore të krimeve kundër komunizmit. 50 milionë viktima ka pasur Lufta e Parë Botërore, ndërkohë që janë mbi 90 milionë viktima nga krimet e komunizmit.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, unë kam folur edhe me drejtuesen, është një fondacion jashtëzakonisht i rëndësishëm për viktimat e komunizmit, në drejtimin e të cilit janë autoritete dhe personalitete të politikës amerikane dhe botërore. Pjesëmarrja në aktivitetet që ata organizojnë, por njëkohësisht mundësia për të qenë pjesë e bordit drejtues nga Autoriteti, do të ishte një gjë jashtëzakonisht e vlefshme. Dhe kjo ka nevojë për një kuotë minimale, të përballueshme, krejt të papërfillshme, që duhet paguar për të krijuar mundësinë që ne të tregojmë se jemi pjesë e qëndresës kundër komunizmit. Për të vlerësuar atë çka kanë bërë ata

që luftuan në sistemin komunist duhet që ne patjetër të jemi pjesë e mbështetjes, dhe kjo nuk është ndonjë shumë e konsiderueshme, e një muzeu në nivel ndërkombëtar që kërkohet të ndërtohet në Uashington për krimet kundër komunizmit.

Ndoshta edhe në rialokimet që mund të bëhen, është tërësisht e mundshme, domethënë në kontaktet që mund të keni, pra të bëhet e mundur të alokohen fonde për të qenë pjesë e kësaj marrëdhënieje. Duhet jo vetëm mos ta lëmë në harresë, por, siç thamë, edhe ta shpjegojmë qartësisht që diktatura komuniste në Shqipëri ka qenë nga diktaturat më të egra: burra, gra, klerikë, fëmijë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...fëmijë, domethënë përfaqësues nga vende të ndryshme, domethënë qytetarë të huaj që kanë jetuar në Shqipëri dhe kështu me radhë.

Ajo që është e dhimbshme, po ashtu, është që akoma në librat tanë shkollorë ne nuk kemi pjesë nga kjo histori. Akoma ne kemi frikë ta flasim të vërtetën rreth kësaj çështjeje, thjesht për ndarje ideologjike. Edhe rezoluta nuk miratohet thjesht për shkak të ndarjeve ideologjike, në një kohë që, kur flasim për mbështetje, ne vetë si Parlament nuk kemi mbajtur një qëndrim në raport me këtë çështje.

Klotilda Bushka – Zoti Mediu, ndjesë që ju ndërpres, janë shumë të drejta ato që po thoni, por duhet të fokusohemi te buxheti, se kemi 5 institucione që presin të dëgjojen.

Fatmir Mediu - E mbylla.

Kam edhe një propozim, duke qenë se jemi me të gjithë kolegët këtu. Meqenëse kemi një institucion të Autoritetit të Dosjeve, do të ishte mirë që Parlamenti të shtrojë para këtij autoriteti, kërkesën për certifikim pa përjashtim, për të gjithë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë. Se tha edhe zoti Alibeaj, që të gjithë punonjësit e administratës duhet të certifikohen, ndërkohë që institucioni më i lartë i zgjedhur i këtij vendi është i pacertifikuar.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Mediu!

Zonja Sula, do jua jap fjalën në fund nëse doni të përgjigjeni, pasi të dëgjojmë diskutimet e pjesëmarrësve.

Zonja Bardeli fjala për ju.

Greta Bardeli - Faleminderit, kryetare!

Në fakt, kjo është një çështje shumë e ndjeshme, dhe si trashëgimtare e parë e kësaj shtrese, e personave të zhdukur, e ndiej shumë personale këtë çështje.

Kështu që, ju falënderoj për të gjithë punën e mirë që keni bërë deri më tani, jo vetëm ju si drejtuese me vizionin për të ndërtuar një mur kujtese, por edhe gjithë stafit tuaj mbështetës!

U duk e çuditshme shtesa e strukturës që keni paraqitur, por unë mendoj se kjo kërkesë duhet të miratohet menjëherë dhe të vendoset patjetër në buxhet, që ne ta kemi një strukturë sa më efikase dhe të përçojmë memorien, kujtesën në çdo institucion.

Ju përmendët pak më parë shkollat, dhe unë mendoj se është shumë e nevojshme që të kemi një memorie edhe tek trashëgimtarët tanë, te fëmijët, të cilët duhet të njohin historinë, të dinë vuajtjet dhe përndjekjet e kombit. Por kjo është një çështje shumë e ndjeshme edhe në aspektin politik dhe forca jonë politike e ka në vëmendje të veçantë ndërtimin e kësaj strukture. Kështu, unë jo vetëm që jam dakord me shtesën për sa i përket strukturës së brendshme, por mendoj se duhet të vendoset që tani në buxhetin e shtetit. Pra, kjo shtesë në strukturë duhet, por duhet edhe rritja e buxhetit për ju si institucion, pasi është shumë i nevojshëm projektimi, ideimi i kësaj kujtese, për projekte sa më efikase, që të kenë impakt edhe te njerëzit.

Prandaj, unë gjej tastin t'ju falënderoj, ju, zonjë, stafin tuaj dhe uroj që të bashkëpunojmë sa më shumë në lidhjen me rritjen e kësaj strukture!

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Bardeli!

Zonja Çupi.

Dhurata Çupi – Edhe unë do të flas shumë shkurt.

Zonja Sula, zoti Mirakaj, së pari, ju falënderoj për të gjithë punën që keni bërë në këto vite!

Gjithashtu, kërkoj që botimet që keni sjellë në Komisionin e Ligjeve, se ndoshta edhe te ne mund të ketë ndonjë anëtar të këtij komisioni që ka mëkate, këto libra, këto botime, trishtuese dhe dëshmi dëshpëruese, ku tregohet se çfarë sistemi kemi kaluar, t'i dërgoni në çdo institucion qendror, ndoshta edhe në Kryeministri, ku vazhdojnë dhe promovojnë figura të ish-Sigurimit të Shtetit.

Keni sjellë një kalendar të aktiviteteve që do të zhvillojë për vitin 2022. Nëse do të miratohet shtesë në buxhet, por besoj se në Komisionin e Ligjeve keni për të marrë votën e të gjithëve, pasi janë aktivitete njëri më i goditur se tjetri, natyrisht, unë jam pak lokaliste dhe më pëlqen aktiviteti me numrin 32, për studimin e dosjeve të Sigurimit në kohën e Mbretit Zog. Kam përshtypjen se kjo është një pjesë e historisë e pastudiuar deri më sot.

Gjithashtu, kërkoj edhe aktivitet për Burgun e Burrelit, pasi është një nga burgjet më famëkeq, dhe shprehja referuar atij burgu ka qenë “Aty ku hyn e s’del më”. Kështu që, dua të ketë aktivitete sensibilizuese, sepse ka histori trishtuese të Burgut të Burrelit, që zoti Mirakaj i di më mirë se unë.

Ashtu siç thashë, është shumë me interes edhe studimi i dosjeve për kohën e Mbretit Zog, kështu që keni mbështetjen tonë. Gjithashtu, uroj që të gjitha këto aktivitete të zhvillohen, dhe patjetër Komisioni i Ligjeve do të jetë bashkëpunues, do të jetë edhe prezent në këto aktivitete, nëse do të njoftohemi nga ju.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Po, zoti Deliu e ka kërkuar fjalën.

Më pas do t'ia jap fjalën zonjës Sula.

Denis Deliu – Faleminderit, kryetare!

E nderuar kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësuese,

Faktikisht puna juaj duket qartë edhe nga librat që na keni sjellë sot, por kemi shumë dëshirë që kjo punë të ekspozohet edhe më tepër, si dhe që ne si deputetë të Komisionit të Ligjeve të njihemi më nga afër, më shumë me gjithçka që bën institucioni juaj.

Si deputetë të maxhorancës jemi pro, që t'ju mbështesim si për strukturën, por edhe për buxhetin që kërkon, në mënyrë që të ekspozohet sa më e detajuar dhe sa më mirë ajo kohë, si dhe krimet që janë kryer nga komunizmi. Jam dakord me gjithçka që thanë deputetët, kolegë të opozitës dhe jemi në mbështetjen tuaj për çdo gjë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Deliu!

Zonja Sula, keni diçka për të thënë?

Gentiana Sula – Me pak fjalë, dua të them se vlerësimet që u thanë këtu vetëm na rrisin përgjegjësinë, pasi ka pritshmëri të larta për punën tonë dhe ne do të mundohemi, të gjithë të punojmë në atë nivel të pritshmërisë.

Për të dyja sugjerimet që dha zoti Mediu, dua të them se ne, kemi bashkëpunime me qendrën që ndodhet në Kongresin Amerikan, për viktimat e komunizmit. Kemi qenë me zotën Simon në 100-vjetorin e Revolucionit Bolshevik dhe e kemi partner këtë institucion. Kishim parashikuar të shkonim përsëri, por për shkak të COVID-it, nuk mundemi.

Është ide shumë e mirë që të kuptohet historia e Shqipërisë si pjesë e fatit botëror, sepse 1/5 e botës ka kaluar në diktatura, kështu që kjo duhet kuptuar dhe bërë me dije për të gjithë botën, por edhe për ne, që të kuptojmë se ka një gjë më të madhe se vendi ynë, si dhe që të mos shikojmë kundër njëri-tjetrit.

Të njëjtën gjë kemi bërë edhe me Belgjikën, ku është muzeu Shtëpia e Europës, me të cilët kemi planifikuar aktivitete.

Gjithashtu, edhe pjesa që ka të bëjë me monarkinë është shumë e rëndësishme, për më tepër kemi edhe një partner kombëtar. Gjithmonë, po e pamë historinë brenda vetes, nuk themi gjë të re, por nëse shikohet edhe nga jashtë, shikohet më bukur dhe ka një kontekst tjetër.

Për sa i përket Burgut të Burrelit, jam më se dakord me atë që propozuat. Ne kemi një projekt që quhet “Dialogu lokal” dhe kemi lënë qyteti 1, qyteti 2. Javës që vjen do të fillojmë me Tiranën, Elbasani është në listë, por edhe Burreli nuk mbetet mbrapa, pasi burgu është brenda në qytet dhe përveç se ka shumë viktime të pagjetura, numërohen rreth 400 persona që janë varrosur aty, janë edhe figura të rëndësishme, 5 prej tyre kanë qenë kryeministra.

Me sa di unë, është menduar që Burgu i Burrelit të mos përdoret më si burg, sepse nuk i ka kushtet e përshtatshme. Unë ua kam thënë të gjithëve, po e them edhe këtu, që do të ishte mirë të mos ta restaurojnë, sepse do të ishte një objekt kujtese shumë interesant. Materiale ka pa fund dhe ne po punojmë përditë që t’i zbardhim. Duke qenë se është brenda në qytet, është edhe një atraksion i trashëgimisë kulturore për qytetin, si dhe nga ana tjetër tregon për lindjen e një klani të fortë, atë të monarkisë. Edhe kjo është pjesë e historisë, kështu ne e mbajmë shënim, që Burreli të jetë pjesë e dialogëve lokalë, të cilët do të fillojnë shumë shpejt. Nëse ka burime dhe partneritet lokal, gjërat bëhen.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Sula!

Zoti Korreshi.

Saimir Korreshi – Faleminderit!

Shkurtimisht, edhe unë dua të them se jam mirënjohës për punën që keni bërë, por edhe një herë dua të përsëri kërkesën që e bëri edhe kolegu më parë, për më shumë studime për personat që nuk u janë gjetur eshtrat, ata që i kemi pjesë të familjeve. Duhet të ketë realisht diçka për të verifikuar të gjithë dokumentacionin për këtë çështje.

Gjithashtu, do të më pëlqente të kishte diçka edhe për kampin e internimit në Savër, sepse vetë qytetarët atje i ruajnë me fanatizëm banesat e kampit. Unë i kam parë, se kam qenë disa herë, por do të ishte e udhës të kishte një projekt edhe për këtë kamp, sepse ndërtesat po degradohen. Nëse do të bëhet diçka për këtë kamp, do të ishte një gjë shumë e mirë, sepse kampi i Savërit ka qenë një nga tmerret e komunizmit.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Po, zonja Sula.

Gentiana Sula – Po të shikoni listën, kemi nisur diçka për Lushnjën. Kemi fotografuar të gjitha kasollet që janë përdoruar nga të internuarit dhe janë rreth 200 banesa që i kemi fotografuar. Kemi bërë një ekspozitë shumë interesante, dokumentare dhe me foto, kemi fotot e kohës që zoti Simon na i ka mundësuar përmes komunitetit. Janë rreth 13 fshatra që janë

përdorur si kampe pune në atë kohë. Krahas suksesit të reformës agrare dhe kolektivizimit që kemi mësuar në shkollë, është dhe kjo pjesë e historisë që nuk njihet fare. Është bërë edhe një memorial në Gurrëz, për bejlerët që janë pushkatuar. Domethënë, do të punojmë akoma për Lushnjën.

Klotilda Bushka – Zonja Sula, nisur nga interesi i lartë i kolegëve për veprimtarinë e institucionit tuaj, mendoj se në kuadër të monitorimit parlamentar, ne si komision do të bëjmë një vizitë në institucion, te godina e re, mbasi t’ju pajisim me mjete, sipas buxhetit, që të keni ku të na prisni. Besoj se kjo vizitë do të jetë e vlefshme për të gjithë kolegët, por edhe për opinionin publik, sepse pyetjet në lidhje me veprimtarinë e institucionit, mund të jenë të tilla, që mund t’i ezurojmë në më shumë kohë, kur të jemi aty në institucion.

Një fjalë të fundit nga zonja Xhixho dhe më pas do ta mbyllim këtë dëgjese.

Erisa Xhixho – Shumë faleminderit, kryetare!

Më vjen mirë që institucioni ka ecur shumë mirë. Mbaj mend në fillim, kur unë kam qenë zëvendësministre e Integritit Europian, që bashkë kemi çuar në Delegacionin Europian kërkesën, ku kemi lobuar për ndërtimin e këtij institucioni dhe jam shumë e lumtur që sot veprimtaria e tij është konsoliduar.

Gjithashtu, jam dakord që ta mbështeteshim institucionin në çdo moment me buxhet, sepse është shumë i rëndësishëm momenti i edukimit qytetar. Dua që edhe të rinjtë ta vizitojnë këtë institucion, që të njohin memorien, kujtesën e të gjithë historisë së Shqipërisë, të të vërtetave që duhet t’i shikojmë në sy dhe do të vlerësoja shumë që ky edukim të vijë, sidomos te brezat e rinj. Në qoftë se brezi im i vitit ‘85 ka pasur mundësi ta jetojë, edhe pse pak, brezat e rinj, pas viteve ‘90, nuk e kanë fare ndjeshmërinë e asaj periudhe. Kështu që, do t’ju sugjeroja që ta keni parasysh edhe këtë gjë në hartimin e politikave tuaja.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Xhixho!

Zonja Sula, besoj se e keni mbështetjen e komisionit. Kjo është e kuptueshme nga diskutimet e të gjithë kolegëve.

Unë mendoj që çështjen e strukturës duhet ta adresojë ky komision, që më pas të bëhet axhustimi në buxhet. Për çështjen e aktiviteteve, siç e diskutuat me ministrinë dhe relatorin, bëni një saktësim, sepse gjërat duhet të jenë të sakta që të referohen në buxhet. Për sa u takon pajisjeve, edhe kjo është një çështje që duhet të adresohet pa diskutim.

Gjithsesi, ne do ta ndjekim këtë çështje para miratimit të buxhetit nen për nen dhe në tërësi dhe do t’ia rekomandojmë me dakordësinë e të gjithëve komisionit përgjegjës.

Shumë faleminderit, për prezencën dhe për punën tuaj!

Punë të mbarë!

Jeni të lirë të shkoni.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.11.2021, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me institucionet me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”.

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Oerd Bylykbashi, Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Gerta Duraku, Dhurata Tyli, Erisa Xhixho, Gazmend Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Elda Hoti dhe Gledis Çeliku.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Fatmir Xhafaj, Jurgis Çyrbja, Toni Gogu, Bledion Nallbati, Ermonela Valikaj(Felaj) dhe Saimir Hasalla.

Të ftuar:

Alfred Balla - Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe anëtar i Këshillit
Sandër Beci - Kryetar i Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Buxhetit
Emis Çerava - Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Klotilda Bushka – Vazhdojmë dëgjesën me Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Alfred Balla, zëvendëskryetar i Këshillit dhe anëtar i tij; zoti Sandër Beci, kryetar i Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Buxhetit dhe zoti Emis Çerava, sekretar i Përgjithshëm i Këshillit.

Mirë se keni ardhur, zotërinj!

Sot jeni të ftuar për projektbuxhetin e vitit 2022, çështjet që ju doni të adresoni, nëse ky buxhet i mbulon nevojat e institucionit dhe nëse doni të shtoni diçka.

Fjala për ju, zoti Balla.

Alfred Balla – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar zotërinj deputetë!

Ju falënderoj që gjetët kohën për të na dëgjuar!

Në mungesë të Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili ka një angazhim jashtë shtetit, sot në dëgjesë kam ardhur unë së bashku me sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit.

Në përgjithësi Këshilli i Lartë i Prokurorisë i ka evidentuar kërkesat buxhetore për vitin 2022. Ne jemi një organ modest me 65 veta, nga të cilët 11 veta janë anëtarë të Këshillit, kurse pjesën tjetër e përbën administrata, ku hyjnë shoferët, këshilltarët dhe disa sektorë ndihmës.

Për zërat që ne kemi planifikuar në vitin 2022 kemi gjetur dakordësinë edhe të Ministrisë së Financave. Kryesisht, pjesa e buxhetit që ne kemi planifikuar ka të bëjë me pagat, sigurimet shoqërore, mallra dhe shërbime dhe dy investime të vogla, të cilat konsistojnë në blerjen e dy automjeteve për anëtarët e këshillit dhe një ndërhyrje në strukturën e ndërtesës për të mbyllur dy ambiente zyrash.

Nuk kemi ndonjë kërkesë tjetër veç këtyre që kemi planifikuar në materialin që ju është dërguar. Jemi të kënaqur edhe me dakordësinë e Ministrisë së Financave. Kjo ishte në mënyrë të përmbledhur. Besoj se edhe ju i keni materialet.

Klotilda Bushka – Po, ne i kemi marrë materialet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Në qoftë se ju nuk keni ndonjë kërkesë shtesë dhe nevojat tuaja mbulohen nga buxheti i vitit 2022, hartuar nga ministria dhe miratuar nga qeveria, unë nuk kam çfarë të shtoj. Besoj se edhe relatori nuk ka çfarë të thotë më tepër. Nëse ndonjë nga kolegët do të thotë diçka, mund ta marrë fjalën.

Në fillim e ka fjalën zotai Sula. Më pas zoti Korreshi dhe zoti Mediu.

Dashnor Sula – Faleminderit, zonja kryetare!

Sigurisht, seanca dëgjimore që kemi sot me Këshillin e Lartë të Prokurorisë është e rëndësishme. Ajo ishte e rëndësishme të bëhej që javën e kaluar, por u shty dhe unë e kuptova

sot shkakun. Është pritur që kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë të mos jetë prezent në Komisionin e Ligjeve për këtë dëgjese. Kjo është për të ardhur keq.

Duke pasur parasysh që Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është një person shumë i afërt i maxhorancës, një drejtuesi të lartë të Partisë Socialiste, nuk është parë e nevojshme nga ana e maxhorancës që ai të jetë prezent këtu për t'u dëgjuar dhe për t'i drejtuar pyetje anëtarët e Komisionit të Ligjeve.

Gjithsesi, zoti Balla është një njeri i nderuar si zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Duke pasur parasysh përvojën e tij si drejtues prokurorie ndër vite në Republikën e Shqipërisë, kam bindjen se mund t'i drejtojmë disa pyetje.

Zoti Balla, me organizimin e ri që i është bërë organit të prokurorisë, pesha kryesore e emërimeve dhe kontrollit të prokurorëve të Republikës së Shqipërisë bie mbi Këshillin e Lartë të Prokurorisë. I kemi të qarta kompetencat që ka sot prokurori i Përgjithshëm, që janë shumë të kufizuara dhe që merren me mbarëvajtjen dhe organizimin e Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorive të shkallës së parë dhe të apelit, por përgjegjësinë për sa i përket mënyrës si performon institucioni i një prokurorie apo një prokuror në veçanti e ka Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Javën e kaluar ne zhvilluam një dëgjese shumë të rëndësishme me Prokurorinë e Përgjithshme. Vetë zëvendësprokurori i Përgjithshëm, zoti Thoma Jano, duke pasur parasysh gjendjen mjaft të rënduar të prokurorisë për shkak të ngarkesës, shprehu rezerva dhe shqetësim mjaft të madh për sa i përket numrit të prokurorëve.

Numri total i organikës së prokurorëve në Republikën e Shqipërisë është 312 ose 320 prokurorë, nga të cilët janë larguar 132 prokurorë, më shumë se 1/3-ta e organikës së prokurorëve. Zëvendësprokurori i Përgjithshëm tha që numri i dosjeve për një prokuror në Republikën e Shqipërisë arrin në 300. Ju e dini mjaft mirë, si ish-prokuror, si ish-drejtues prokurorie, çfarë i duhet një prokurori për të plotësuar një dosje hetimore dhe për ta dërguar atë në gjykim apo për të marrë një vendim tjetër.

Klotilda Bushka – Zoti Sula, nuk dua t'ju ndërpres, sepse shqetësimet tuaja i vlerësoj dhe kanë rëndësinë e vet, por duke qenë se jemi në dëgjese për buxhetin, do të doja të fokusoheshit te kjo çështje.

Dashnor Sula - Pikërisht, pra. Buxheti këtu është.

Klotilda Bushka – Këshillin e Lartë të Prokurorisë do ta kemi të pranishëm në raportimin vjetor të institucionit dhe ju mund t'i bëni të gjitha pyetjet që keni. Mund të ezaurojmë një seancë gjithë ditën me Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Për momentin, duke qenë se po flasim për buxhetin, do t'ju lutesha të fokusoheshit në këtë çështje.

Nëse dëshironi të bëjmë një dëgjese më herët sesa ajo për raportin vjetor, ne mund ta kërkojmë, sepse e kemi këtë të drejtë, por për ekonomi kohe dhe në respekt të Rregullores për rendin e ditës, ju lutem të fokusoheni sa më shumë te çështjet e buxhetimit për ushtrimin e nevojave.

Faleminderit!

Dashnor Sula – Faleminderit për sugjerimet, zonja kryetare!

Për fatin tënd të mirë, ti je kryetare e komisionit dhe ne të dëgjojmë çdo ditë. Ti i di të gjitha dhe bën komente për këdo. Për çdolloj dëgjese që kemi pasur këtu, ke folur disa herë dhe është e drejta juaj, por do t'ju lutesha shumë të mos na paragjykoni për çfarë themi ne dhe si e ndërtojmë ne diskutimin. Ne kaq e kemi nivelin profesional dhe kështu dimë t'i drejtojmë pyetjet.

Klotilda Bushka - Nuk po ju paragjykoj, zoti Sula dhe hiqeni termin “paragjykim”. Besoj se jam shumë e drejtë në komentet që bëj.

Dashnor Sula - Do ta heq kur të hiqni ju kompleksitetin që keni.

Klotilda Bushka – Unë po ju kërkoj që, në respekt të Rregullores, t'i qëndrojmë rendit të ditës. Sigurisht, ju jeni i lirë të flisni sa herë të doni, por këto janë rregullat, të cilat nuk i kam vendosur unë.

Dashnor Sula – Nëse ti, zonja kryetare, nuk ndihesh e shqetësuar për këtë gjë, por ndihesh e shqetësuar për një problem tjetër më të vogël, unë mendoj që rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë e vitit 2021 është jashtëzakonisht shumë e rëndësishme dhe deri diku ka qenë kritikuese, sepse ka rënë numri i dosjeve të dërguara për gjykim. Njësia matëse kryesore e një prokurori ka të bëjë me cilësinë e hetimit, me numrin e çështjeve të përfunduara në gjykatë, si dhe me deklarimin fajtor të atyre personave që kanë kryer këto vepra penale. Bëhet fjalë për mbi 10% të numrit të dosjeve të kaluara për gjykim krahasuar me vitin 2020. Ky është një tregues mjaft negativ. Për shkak të numrit të çështjeve që ka në ngarkesë një prokuror, cilësia e hetimit ka rënë jashtëzakonisht.

Pyetja dhe shqetësimi im për Këshillin e Lartë të Prokurorisë është: si mund t'i dalim përpara këtij problemi, që do të thellohet në muajt në vazhdim?

Nëse deri tani nga sistemi janë larguar 132 prokurorë, në sajë të zhvillimit të vetingut, sigurisht do të ketë përsëri largime.

Rekrutimi i prokurorëve duhet të kryhet nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që e ka ose nuk e ka këtë mundësi. Për sa i përket numrit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, në organikë kemi 250 oficerë të Policisë Gjyqësore, në një kohë që kemi 200 oficerë të Policisë Gjyqësore në detyrë.

Unë i kërkoj Këshillit të Lartë të Prokurorisë: a mundeni ju të bëni plotësimin e vakancave që kanë prokuroritë e rretheve dhe të apelit? Kemi prokurori me shumë pak, për të mos thënë 2 ose 3 prokurorë?

Nëse nuk bëhet plotësimi i numrit të vakancave për prokurorët, a keni mundësinë të ushtrohet presion te Ministria e Financave, meqë zonja kryetare ka problem buxhetin, që nga 10, që ishin planifikuar çdo vit, për të arritur pas 4 vjetësh numrin 250 oficerë të Policisë Gjyqësore? Ne të bëjmë të mundur që brenda këtij viti të shtojmë 50 oficerë të Policisë Gjyqësore dhe të përgatiten dosjet për prokurorët që t'i ndihmojmë prokurorët, sepse hetimin e bëjnë edhe oficerët e Policisë Gjyqësore? Meqë e kishte merak kryetarja.

Pyetja e dytë ka të bëjë me hartën gjyqësore. Harta gjyqësore është një shqetësim jashtëzakonisht i madh për këdo, duke filluar nga KLP-ja, nga Prokurori i Përgjithshëm dhe, çka është më e rëndësishme, nga qytetarët shqiptarë. Pse e them këtë gjë? Po marr qarkun e Elbasanit, që është një qark me shtrirjen më të madhe në Republikën e Shqipërisë. Kufizohet me Maqedoninë dhe përmes detit me Italinë, por ka vetëm një prokurori që është prokuroria e qarkut të Elbasanit. Numri i prokurorëve dhe i oficerëve të Policisë Gjyqësore është i mangët. A mund të zotërohet territori nga një prokurori qendër-qarku për të gjithë këtë territor (kur flas për Elbasanin kam parasysh edhe të gjitha qarqet e tjera, sepse është problematikë jashtëzakonisht e madh? Aq më tepër që diskutohet dhe ne morëm një konfirmim nga kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami, e cila tha: “E kemi përgatitur një hartë gjyqësore, të cilën nuk e kemi shpallur, por që bëhet fjalë si suprimim i shumë prokurorive të tjera”. Ju, si KLP, a jeni dakord me këtë hartë gjyqësore? A keni paraqitur problematikat, të cilat i janë vënë në dispozicion KLGJ-së apo Ministrisë së Drejtësisë që të mos bëhet një hartë e tillë gjyqësore? Në fund të fundit, ju e dini shumë mirë, dhe unë e thashë që në fillim, që të bësh një hetim penal është jashtëzakonisht e vështirë duke filluar që nga këqyrja e vendit të ngjarjes deri te hetimi, i cili ka një specifikë shumë të vështirë.

Doja të dija qëndrimin e KLP-së nga fillimi deri në fund për këtë hartë gjyqësore.

Pyetja tjetër që kam, është një pyetje që ia kam paraqitur edhe zonjës Llagami si kryetare e KLGJ-së dhe, sinqerisht, si deputet, por edhe si ish-prokuror, dëgjova një përgjigje profesionale nga ana e kryetares së KLGJ-së. Do të dëshiroja që edhe ju, si zëvendëskryetar i KLP-së, por, në mungesë të kryetarit (pa dashur absolutisht të vë shenja dizavantazhi për ju), të jepnit një përgjigje të sinqertë, profesionale dhe të vërtetë. Pyetja është e drejtpërdrejtë: ju si KLP, që presupozohet që e njihni legjislacionin nga a-ja deri te zh-ja në mënyrën më të mirë të mundshme, më mirë se kushdo, madje më mirë se deputetët e Komisionit të Ligjeve, nëse ju i jeni drejtuar Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë apo qeverisë, duke pasur

parasysh detyrimet kushtetuese për sa i përket vetingut, i cili i kalon në kompetencë të drejtpërdrejtë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë KLP-së, dhe a keni bërë një studim se çfarë mjjetesh dhe nevojash financiare e logjistike ju nevojiten për të kryer vetingun që në qershor 2022 i kalon automatikisht KLP-së?

A i jeni drejtuar qeverisë dhe Ministrisë së Financave për fondet e nevojshme për të kryer këtë veting që është mjaft i rëndësishëm? A i keni kapacitetet? Nëse e keni bërë këtë, çfarë përgjigjeje keni marrë? Po ju them në parantezë se ministrja e Financave ka deklaruar këtu se nuk ka pasur një kërkesë as nga KLGJ-ja, as nga KLP-ja.

Si qëndron e vërteta?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Urdhëroni, zoti Korreshi!

Saimir Korreshi – Unë jam i interesuar për Prokurorinë e Lushnjës. Sipas hartës gjyqësore, por edhe nga ndjeshmëria që ka ai komunitet, Lushnja vetëm si rreth gjyqësore, ose Prokuroria e Lushnjës, si koncept i rrethit gjyqësor, është më e madhe se tri qarqe të tjera, ai i Kukësit, ai i Dibrës dhe ai i Gjirokastrës. Janë gati 200 mijë banorë dhe ka një numër të jashtëzakonshëm çështjes gjyqësore. Nuk do t'i hyj kësaj pune, se kjo është një specifikë tjetër e parë nga ana e vetingut se çfarë ka ndodhur. Sot Prokuroria e Lushnjës ka një volum të jashtëzakonshëm kërkesash dhe kallëzimesh, por një numër të reduktuar prokurorësh.

Së pari, çfarë po bëhet në këtë drejtim?

Së dyti, për hartën territoriale është dëgjuar në biseda konfidenciale që Lushnja nuk do të përfshihet më në hartën gjyqësore, pra një qytet me 200 mijë banorë, duke përfshirë edhe Divjakën, nuk do të kenë më një prokurori pas 30 vjetësh, gjithë jetën e saj nuk do të këtë më një prokurori. A jeni ju në dijeni të një harte gjyqësore? Çfarë kushtesh reale keni konceptuar dhe si e keni përgatitur? Çfarë kriteresh keni pasur parasysh për ta hequr këtë prokurori, duke qenë se ka një VKM që përcakton numrin ekzakt mbi 280 mijë banorë, ndërkohë që, realisht, janë mbi 200 mijë banorë? A ka efekt ekonomik kjo gjë, sepse të gjithë njerëzit për të dhënë një deklaratë do të shkojnë në Fier, 40 km, pra për efekte hetimi humb realisht? Për të thërritur dëshmitarë në gjykatë po edhe në prokurori do t'i çojmë 40 veta në Fier, ndërkohë që edhe atje nuk ka zyra, se prokuroria atje është për të të ardhur keq, në zyrë rrinë nga 3-4 veta, prokurorë dhe oficerë të Policisë Gjyqësore. A është bërë një analizë e të gjithë këtyre faktorëve, plus edhe ato që përmendi zoti Sula? A e keni dhënë ju, si KLP, konsensusin për të hequr prokurorinë e Lushnjës?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Urdhëroni, zoti Mediu!

Fatmir Mediu – Ju pa dyshim që prezantuat këtu buxhetin për KLP-në, por në funksionet që kryeni, ju keni edhe analizën e punës së të gjitha prokurorive. Ne kemi një shqetësim shumë të madh këtu si komision, në bazë të dëgjësës që patëm me zëvendësprokurorin e Përgjithshëm. Në përfundim ai tha se afërsisht vetëm 1/3 e prokurorëve janë eficientë dhe mungesat e kapaciteteve njerëzore në situatën e krimit dhe të problemeve që kemi është një kambanë shumë e madhe alarmi.

Ndoshta, një marrëdhënie juaja me Prokurorinë e Përgjithshme mund të bënte që ne të kishim një vështrim pak më të qartë për nevojat financiare dhe kapacitetet njerëzore që duhen për këtë çështje, duke përfshirë këtu edhe Policinë Gjyqësore.

E dyta, uroj ta kem gabim, por dëgjova pas mbledhjes së Këshillit të Legjislacionit që konstitucionalistë apo analistë të drejtësisë thanë që KLP-ja dhe KLP-ja nuk i kanë kapacitetet profesionale për të kryer vetingun. Uroj ta kem gabim, por, në qoftë se është kështu, atëherë ne e kemi kthyer reformën e drejtësisë me kohë poshtë, sepse pretendohet se KLP-ja dhe KLGJ-ja janë njerëzit më të përgatitur, me formim dhe integritet shumë herë më të madhe se elementet që varen prej tij, apo jo? A pajtoheni me këtë konstatim?

Kjo lidhet edhe me atë që u ngrit nga kolegët, sepse ju keni detyrimin kushtetues që në muajin qershor duhet të filloni procesin e vetingut. Dua të di nëse e keni apo nuk e keni këtë nivel profesional. Në qoftë se e keni, a keni bërë kërkesë pranë Ministrisë së Financave dhe a keni një përgjigje prej saj për sa i përket zbatimit të detyrimit kushtetues, jo vetëm financiarisht, se nuk është çështja që e filloni në qershor, se në qershor fillon procesi, por kapacitet njerëzore dhe institucionale ndërtohen para se të fillojë procesi, përndryshe do të krijonim një boshllëk jashtëzakonisht të madh dhe një problem në të gjithë procesin e vetingut?

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Mediu!

Urdhëroni, zoti Denis Deliu!

Denis Deliu – I nderuar zëvendëskryetar,

Kam dy pyetje.

Pyetja e parë lidhet me pyetjet e kolegëve. Si deputet i rrethit të Krujës, jam i shqetësuar për hartën e re gjyqësore dhe dua të di për Prokurorinë e Krujës, sepse ka goxha çështje rrethi i Krujës dhe duhet të bëhet një studim shumë i mirë para se prokuroria të lëvizë nga ky rreth.

E dyta, për shkak të vakancave nga vetingu në sistemin e drejtësisë, a do të kemi një shtim të numrit të prokurorëve këtë vit në Shkollën e Magistraturës? A është parashikuar kjo nga ju?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Deliu!

Para se t'ia jap fjalën zotit Balla, unë dua të sqaroj që zoti Gent Ibrahimimi ka qenë i pranishëm për dëgjesën herën e kaluar dhe këtë javë të gjithë krerët e institucioneve të drejtësisë janë jashtë në një takim me ftesë të qeverisë gjermane, prandaj ka qenë e pamundur të ishte prezent këtu. Pra, nuk është se nuk ka dashur të vijë zoti Ibrahimimi, për të qartësuar atë dyshim që ngriti zoti Sula.

Në këshillim me nënkryetarin e komisionit vendosëm ta bëjmë javën tjetër dëgjesën, që të ishte zoti Ibrahimimi, por, duke qenë se afatet e kalendarit të buxhetit janë të tilla që miratohet buxheti në parim në seancën plenare të datave 15 dhe 16, do të donim ta dëgjonim institucionin, i cili, në mungesë të kryetarit, përfaqësohet nga zëvendëskryetari. Kjo sa për të sqaruar se nuk ka pasur ndonjë gjë të qëllimshme në lidhje me këtë çështje dhe, në fakt, shtyrja është bërë për efektin tonë, jo për efekt të institucionit.

Zoti Balla, ju morët shumë pyetje që kanë të bëjnë në institucionin, të cilat nuk kanë lidhje me rendin e ditës. Megjithatë, është në çmimin tuaj të ktheni përgjigje për aq sa jeni përgatitur. Gjithsesi, mendoj që ne këto çështje do të duhet t'i ezaurojmë në një seancë të plotë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ku të gjithë kolegët të kenë mundësi të mësojnë më shumë.

Fjala është për ju.

Alfred Balla – Faleminderit!

Të nderuar zotërinj deputetë,

Në parantezë, do të isha i pranishëm edhe sikur të ishte kryetari zoti Ibrahimimi, sepse zotit Ibrahimimi për një muaj i mbaron mandati, unë jam anëtar, kam mandat edhe 2 vjet të tjerë. Prandaj, meqenëse bëhet fjalë për projektbuxhetin e vitit 2022, do të isha unë më tepër i interesuar sesa zoti Ibrahimimi, të cilit i mbaron mandati. Jam në gjendje t'u përgjigjem të gjitha pyetjeve, pavarësisht se një pjesë nuk lidhen me projektbuxhetin.

Numri i prokurorëve që po shteron ditë për ditë, zoti Sula, është problem edhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Personalisht besoj se ne mund të organizojmë edhe një takim tjetër me Komisionin e Ligjeve, se përveç jush nuk kemi se me cilin t'i qajmë hallet. Jemi organ kushtetues dhe i vetmi organ ku ne trokasim jeni ju. Prokuroria ndihmën e ka emergjente, pasi ky është viti më i keq për organin e prokurorisë. Duhet t'ju ketë thënë këtë gjë edhe zëvendësprokurori i Përgjithshëm. Nga statistikën që kam nxjerrë, janë rreth 71 prokurorë të shkarkuar, janë 71 prokurorë të konfirmuar në detyrë, janë 15 prokurorë deri tani që kanë hequr dorë, si dhe daljet në pension, proceset njerëzore, të cilat kanë bërë që në total numri i prokurorëve në detyrë në Republikën e Shqipërisë të jetë 220, por organika është 341. Shihet një thellim në mungesën e burimeve njerëzore. Prokuroria, me thënë të drejtën, është në hall.

Ndoshta miratimi i hartës së re gjyqësore do të bëjë njëfarë rregullimi, por kjo është për t'u parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta sqaroj te problematikat e hartës.

Për fat të keq, nga Shkolla e Magjistraturës këtë vit nuk presim asnjë student. Pra, në mënyrë të përafërt vitin tjetër në këtë kohë do të jemi në gjendje të emërojmë gati 22 prokurorë që kemi. Për një vit, duke marrë parasysh dorëheqjet, ngeljet që mund të bëhen gjatë procesit të vetingut, mendojeni vetë se si do të jetë gjendja. Deri vitin tjetër do të jetë më keq. Këtë e them me bindje. E kam ngritur zërin dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Jua them edhe juve këtu në komision, pasi në mënyrë urgjente parlamenti dhe qeveria duhet të gjejnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në lidhje me OPQ-të që pyeti zoti Sula, në fakt, oficerët e Policisë Gjyqësore janë në organikën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe nuk varen nga. Ai e përcakton numrin. Personalisht, do të isha me idenë që një dyfishim i numrit të oficerëve të Policisë do të bënte që prokurorët aktualë të kishin një ndihmë më të madhe që të evadonin dosjet, të cilat janë të shumta.

Në lidhje me hartën e re gjyqësore që ka lidhje edhe me prokurorinë e Elbasanit, aktualisht nuk na është marrë asnjë lloj mendimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Ministria e Drejtësisë. Në kontaktet që kemi bërë me ministrin e ri të Drejtësisë na është thënë se do të jemi pjesë, pasi të përgatitet një draft dhe ne do të japim mendimin tonë. Është e domosdoshme që ne të japim këtë mendim, pasi prokuroria është pjesë e pandarë e gjyqësorit. Vërtet quhemi prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, por hetimi penal është ai që furnizon edhe gjykatat. E kemi ngritur këtë shqetësim edhe në mbledhje, pasi as Prokurori i Përgjithshëm, me sa di unë, nuk është pyetur, të paktën deri kur erdhi e raportoi përpara Këshillit, pra nuk i është marrë mendim. Presim që Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor të na vejë në dijeni, të na japë draftin që të japim mendimet tona. Në Këshill janë 6 prokurorë me shumë eksperiencë, të cilët mund të japim mendime të vyera për ndarjen gjyqësore, për hartën e re gjyqësore, sepse prokuroria është e lidhur ngushtë me gjykatën, pra se cila prokurori ia vlen të shkrihen, cila jo, por deri tani jemi në pritje dhe të aftë të japim një përgjigje.

Lidhur me pyetjen e tretë nëse KLP-ja ka përgatitur ndonjë studim për procesin e vetingut, që mund të fillojë pas 6 muajsh, jo KLP-ja deri sot nuk ka përgatitur asnjë studim në lidhje me vazhdimësinë e procesit të vetingut që, në bazë të Kushtetutës, pas muajit qershor na takon neve, kur përfundon afati 5-vjeçar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe i komisionerëve publikë, të cilët do të zëvendësohen nga drejtuesi i SPAK-ut. Pse nuk e kemi

bërë? Ne kemi menduar, të paktën deri sot, që buxheti për kryerjen e rivlerësimit kalimtar është pjesë e buxhetit tërësor, të planifikuar për KPK-në për vitin 2022, i cili shumë lehtë mund të transferohet, pjesa deri në qershor që është planifikuar për organet e vetingut, t'u kalojë atyre, ndërsa pjesa tjetër të na kalojë së bashku me KLGJ-në. Besoj dhe jam i bindur se buxhet të planifikuar nga qeveria për këtë pjesë ka dhe duhet të ketë.

Procesi i rivlerësimit është në proces e sipër, është në realizim dhe unë shoh se deri sot kanë kaluar gjysma e prokurorëve dhe të ndihmesave ligjorë. Janë rreth 168 subjekte pa kaluar akoma procesin e vetingut. Nga qershori, edhe dy muaj të këtij viti, i bie gati për 8 muaj të krijojmë një tablo më të qartë apo për 6 muaj, sesa prokurorë do të kalojnë nga KPK-ja që është aktualisht. Planifikimet tona duhet të jenë të bazuara, sepse mundet që KPK-ja të kalojë komplet gjyqtarët apo komplet prokurorët dhe nuk kemi nevojë ta bëjmë, por kjo është për t'u parë. Është një periudhë gati 8-9 mujore dhe ne duhet të jemi në gjendje të bëjmë një ministudim. Personalisht, jam i mendimit që buxheti i planifikuar për KPK-në dhe për komisionerët shumë mirë mund të listohet në dysh për KLGJ-në dhe KLP-në. Komisionerët publikë dhe anëtarët që janë rreth 14, nuk do të jenë më pjesë, por ndërkohë jemi dy këshilla, janë 22 anëtarë. Aktualisht, me sa di unë, 36 ka sot KPK-ja, 18 shkojnë për KLGJ-në dhe 18 për KLP-në. Plus ne kemi edhe pjesën tonë të stafit, kemi rreth 12 këshilltarë ligjorë. Po të bashkohen edhe këta, pastaj mund të ketë nevojë për ndonjë rregullim ligjor tranzitor në kuptimin e transferimit të dosjeve apo të godinës apo ku do të rrimë, por ky është një problem që deri tani, nuk e kemi menduar. Jemi nisur nga fakti që në faqen zyrtare të Kuvendit është publikuar një nismë ligjore për ndryshimin, i cili propozon zgjatjen e mandatit, por kjo ju takon juve. Jemi në pritje të vendimmarrjes së deputetëve, ne do të zbatojmë vendimmarrjen tuaj.

Pyetjet që kanë lidhje me hartën territoriale janë të ezauruara, kjo është edhe për Lushnjën, edhe për Krujën. Nuk kemi dhënë asnjë mendim se cila prokurori do të shkrihet. Nuk jemi pyetur deri sot. Do të japim mendimin tonë kur të vijë momenti.

Në lidhje me pyetjen për marrëdhënien me Prokurorin e Përgjithshëm, janë në mënyrë institucionale, janë të mira. Shqetësimet e Prokurorit të Përgjithshëm dhe tonat i *share*-im me njërit-tjetrit. Propozimi për shtimin e numrit të oficerëve të Policisë Gjyqësore duhet të vijë nga Prokurori i Përgjithshëm, sepse ne nuk kemi, buxheti ynë është vetëm për prokurorinë. Në ndryshim nga KLGJ-ja që ka gjithë buxhetin e gjykatave, KLP-ja ka vetëm buxhetin e tij. Nuk kemi ndonjë kompetencë më shumë për të shtuar apo për të kërkuar buxhet që të ndikojë në cilësinë apo në shtimin e numrit të prokurorëve. Numri i prokurorëve me organikë është goxha deri sot, por ne kemi mungesë të prokurorëve. I bie që fondet të mos i djegim edhe në

Prokurorinë e Përgjithshme, se, po nuk pate burime njerëzore, ato fonde do të mbeten, të paktën pjesa që ka të bëjë me pagat dhe me sigurimet shoqërore.

Në lidhje me kapacitetin për vetingun që tha zoti Mediu, unë besoj që KLP-ja i ka këto kapacitete, është absurditet të thuash që nuk ka. Ne me ligj kemi 3 vjet që bëjmë vetingun për magistratët e rinj. KLP-ja bën veting për 20-25 magistratë të rinj, të cilët hyjnë në sistem dhe, kur mbarojnë Shkollën e Magistraturës, përsëri iu bëjmë veting të dytë. Pra, ne jemi në proces, Komisioni për Vlerësimin ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka problem. Kjo është e saktë. Nuk bëhet fjalë për mungesë të kapaciteteve, madje një këshill me 11 veta mund ta gjykojë një gjyqtar ose një prokuror më mirë sesa...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në lidhje me shqetësimin që kishte për shtimin e numrit të studentëve në Shkollën e Magistraturës, në fakt, Këshilli i Lartë i prokurorisë çdo vit ka ardhur duke e shtuar numrin e studentëve, por kjo ka qenë gjithmonë e kushtëzuar nga hapësira që ka Shkolla e Magistraturës, sepse pastaj lidhet me rënien e cilësisë. Nëse të gjithë ata që do të kandidojnë, do të bëhen gjyqtarë e prokurorë, ndodh që cilësia në shkollë të bjerë, por dhe aftësitë, kapacitetet, gjithmonë në korrespondencë me Shkollën e Magistraturës jemi munduar t'i ngremë, sepse ne kemi shumë nevoja. Ne presim që për tre vjet, duke filluar nga nëntori i vjetshëm, të na hyjnë në sistem rreth shtatëdhjetë prokurorë të rinj, të cilët janë duke vazhduar Shkollën e Magistraturës.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Balla!

Ka ndonjë koment tjetër?

Po, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Do të bëj pyetje të thjeshta dhe përgjigjet do t'i doja të shkurtra, sepse nuk do të bëj asnjë lloj koment.

Sapo thatë që KLP ka bërë veting të magistratëve të rinj. Sa është numri i tyre deri tani? Afërsisht. Nuk e dua në kokë, por afërsisht.

Alfred Balla – Sa është numri? Diku te gjashtëdhjetë e ca studentë, për tre vjet.

Enkelejd Alibeaj – Për tre vjet?

Alfred Balla – Sepse aq ka qenë numri i studentëve që kanë hyrë në sistem. Po të kish qenë më i madh, normal që do të kishim detyrimin... Ah, sa? Në rregull!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Gjashtëdhjetë e ca procese vetingu për tre vjet.

Pyetje. Nga statistikat tuaja: nga KPK, sa prokurorë, pra prokurorë, jo gjyqtarë, u janë nënshtruar vetingut deri tani? Nuk po flas për ata që janë larguar, po për ata që janë në proces. E kuptoni këtë, se çfarë do të thotë.

Alfred Balla – Deri para dy ditësh, nga statistikat që unë kam, është trajtuar gjysma e prokurorëve të republikës, gati 168 prokurorë, ku përfshihen edhe dorëheqjet, edhe daljet në pension, pra çdo prokuror i larguar nga lista prej 336 prokurorësh e ndihmësish, që kanë hyrë në procesin e vetingut.

Enkelejd Alibeaj – Pra, njëqind e gjashtëdhjetë e tetë? Hiq këtu ata që kanë dhënë dorëheqjen, sepse kush jep dorëheqjen mbaron punë. Kush del në pension, edhe ai ka mbaruar punë dhe nuk është çështje e KPK-së. Tani jemi në 2021-shin, nga 2017-a deri në 2021-shin janë pesë vjet. Pesë vjet duhet të jenë afërsisht, në mos gaboj, diku rreth 130-140 prokurorë, të cilët u janë nënshtruar vetingut të KPK-së? Nuk gaboj.

Domethënë, shihni çfarë situatë kemi sot. Ne kemi një situatë, ku KPK-ja bën veting, me tridhjetë subjekte në vit. Njëqind e pesëdhjetë pjesëtim për pesë bëjnë tridhjetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më shihni të çuditur. Është matematikë e thjeshtë. Njëqind e pesëdhjetë deri më sot, në pesë vjet, nga 2017-a deri më 2021, është e thjeshtë: tridhjetë.

KKP-ja ka bërë deri më sot gjashtëdhjetë e pak më tepër në tre vjet, që do të thotë njëzet subjekte në vit. Madje, vetëm ata që vijnë nga Shkolla e Magjistraturës, sepse nëse do të kishit edhe të tjerë. Mund të bënit edhe më shumë. Nuk e di, por qëndrojmë tek shifra njëzet në vit.

Dua të them: ju jo vetëm që e keni për detyrë kushtetuese, e pritshme deri në 2022-shin, 17 qershor 2022, por ju keni filluar që prej tre vjetëve me procesin e vetingut. Jam i saktë? Në rregull!

Pra, do të thotë se nuk është se ju bie si bombë fakti që më 17 qershor do të filloni nga ky proces. Ju jeni bërë gati, keni eksperiencë, keni traditë.

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, nuk dua t’ju ndërpres...

Enkelejd Alibeaj – Ja ta mbaroj. Janë pyetje.

Klotilda Bushka – Ju lutem, këto janë pyetje që mund t’i ushtroni në procedurën parlamentare për propozimet.

Enkelejd Alibeaj – Të lutem, zonja kryetare!

Klotilda Bushka – Sot për buxhetin, ju lutem!

Enkelejd Alibeaj – Kolegë, parashtresa është pjesa logjike për të arritur te pyetja, dhe tani pyetja që do t’i bëj unë tani zotit Balla. Unë se në ndarjen që është mes jush, në KLP, personi i ngarkuar për çështjet buxhetore është kryetari. Kështu e di unë.

Alfred Balla – Ne i ndërrojme një herë në dy vjet e gjysmë, kështu që kanë ndryshuar. Ka qenë deri në qershor.

Enkelejd Alibeaj – Ju dëgjova në përgjigjet që dhatë. Më çfarë kuptova unë, më korrigjoni nëse nuk jam i saktë, për çështje të vetingut, në 2021-shin, ju si KLP nuk keni ndërmarrë asnjë masë apo veprim lidhur me Ministrinë e Financave, për të përcaktuar nevoja shtesë, parash shtesë, siç kishte bërë KLGJ-ja, homologu juaj ca kohë më parë. Mund ta dini, por po jua them: KLGJ-ja, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në detyrimin që ka, që në 2022-shin, në qershor, do të fillojë procesin e vetingut për gjyqtarët, ka nisur një proces studimi që në prill të 2021-shit të këtij viti. Jo vetëm kaq, por bazuar në këtë studim, në gusht i ka kërkuar Ministrisë së Financave për një funksion shtesë, që do t'u vijë atyre vitin e ardhëm, parë dhe njerëz. Kjo më duket logjike. Ajo që s'më duket logjike, të them të drejtën, dhe pres që ju të ma sqaroni, është: përse një organ homolog, ju, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, nuk e keni bërë një gjë të tillë, nën pavarësinë tuaj në këtë proces, por, më lejoni ta them këtë, ju u shprehët: si të vendosë qeveria. Do t'ia lërë KLGJ-së apo KLP-së?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si të vendosë parlamenti. Ndërkohë, pyetja që kam unë, se këto ishin me pikëpyetje, është kjo: ku e dini ju se do të ndryshojë Kushtetuta?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'e kam mbaruar akoma.

Për ju si jurist, situata është kjo që është. Më 17 qershor, ju si KLP keni detyrimin të filloni me çështjen e parë të vetingut të prokurorëve, gjë për të cilën do të duhej të kishit bërë edhe kërkesat ndaj Ministrisë së Financave. S'i keni bërë, e kjo do të thotë se jeni të gatshëm, sepse deri tani treguat se keni filluar me vetingun. Do të thotë se keni kapacitete, keni metodologji, keni mekanizma, keni edhe koshiençën institucionale në këtë mes.

Pyetja që kam unë, është e thjeshtë për një jurist dhe për një përfaqësues të institucionit të pavarur: çfarë pune keni ju me atë që bëjnë grupet parlamentare politike në parlament, me iniciativat e tyre? Mund të ndodhin, mund të mos ndodhin këto, ju keni një fakt të sigurtë: vetingun. Po sikur më 17 qershor të jeni ju, që do të bëni vetingun. Ju nuk keni bërë kërkesë për fonde. Për staf shtesë nuk keni bërë kërkesë. Për më tepër, logjika do të donte që këto kërkesa për staf shtesë t'i bënit kohë më parë, sepse minimalisht do të duhet t'i trajtoni. Ata që i keni, i keni, por mund t'ju duhen edhe të tjerë. Janë tetëmbëdhjetë këshilltarë apo jo, që duhet të kalojnë nga andej, këndeje? Mund të keni nevojë t'i trajtoni.

A nuk përbën kjo një problem në mbarëvajtjen dhe përshpejtimin e procesit të vetingut apo jo? Kanë një pikëpyetje të gjitha ato çfarë thashë.

Klotilda Bushka – Zoti Balla!

Alfred Balla – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Në lidhje me pyetjen që bëtë, që ku e dini ju, unë e thashë në parantezë, se në faqen zyrtare të Kuvendit është publikuar një nismë ligjore për ndryshimin e nenit të Kushtetutës. Në qoftë se parlamenti shqiptar do të vendosë, ajo është punë e parlamentit, dhe ne jemi të detyruar të zbatojmë vendimin e parlamentit pa asnjë lloj paragjykimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bardhi, ju nuk ishit, por unë në fjalën time...

Klotilda Bushka – Më fal pak, zoti Balla, sa të bëj një sqarim për kolegët. Më pas do të merrni sërish fjalën.

Në të gjitha dëgjesat që kemi bërë këtu me institucionet që kanë lidhje me funksionet e vetingut, qoftë ato që janë duke e kryer aktualisht, e që e kanë mandatin deri më 17 qershor 2022, qoftë me këshillat, që mund t'u kalohet pas kësaj date, është stërsqaruar nga Ministria e Financave, që buxhetohet për vitin e ardhshëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është ligji i buxhetit, është mekanizëm i ligjit të buxhetit. Buxhetohet funksioni, jo institucioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Alibeaj, unë ju dëgjoj me vëmendje kur flisni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Buxhetohet funksioni, nuk buxhetohet institucioni. Buxhetimi i funksionit, në vijim të parashikimeve ligjore. Kjo është një gjë që mund ta verifikoni me ligjin e buxhetit, si bëhet buxheti, si hartohet buxheti, cilat janë mekanizmat e buxhetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po jua them, sepse nuk ishit në seancën e kaluar, ku u stërsqarua mekanizmi buxhetor i hartimit të buxhetit. Buxhetohet funksioni, nuk buxhetohet institucioni.

Enkelejd Alibeaj – Atëherë, zonja kryetare, me këtë ti nuk po bën nuk gjë tjetër veçse po influencon në përgjigjen e tyre.

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj ...

Enkelejd Alibeaj – Ata janë juristë, t'i dëgjojmë, pastaj si e bën Ministria e Financave, është tjetër histori.

Klotilda Bushka – Unë po citoj parashikimet ligjore. Nëse flasim për influencim të institucioneve, më sugjestionuese se pyetjet tuaja, nuk besoj se ka.

Enkelejd Alibeaj – Pyetjet nuk janë asnjëherë sugjestionuese.

Klotilda Bushka – Unë po them se çfarë parashikon ligji.

Enkelejd Alibeaj – Komentet që bëni ju janë të tilla.

Klotilda Bushka – Çfarë parashikimi ka ligji e sqaroi në disa seanca, në këto dëgjesa, vetë Ministria e Financave. Mund t'ua japim përsëri fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Financave për ta sqaruar...

Enkelejd Alibeaj – Të dëgjojmë pikëpamjet për zbatimin e ligjit nga një institucion i pavarur, është më e mira.

Klotilda Bushka – Atëherë, bëni sikur nuk e dini dhe e keqinterpretoni.

Zoti Balla vazhdoni me përgjigjet.

Alfred Balla – Po vazhdoj aty ku e lashë. Për vazhdimin e procesit të rivlerësimit ka buxhet të planifikuar. Unë nuk mendoj që nuk ka. Ne kemi bërë një studim, sepse mendojmë se lekët janë dhe buxhetet do të ndahen mes dy institucioneve, KLGJ-së dhe KLP-së. Kjo për mua si jurist është e thjeshtë.

Ne kemi parë dhe e dimë shumë mirë që qeveria bën rialokime të fondeve dhe do t'i kalojë nga një xhep në tjetrin, pra ne nuk kemi problematikë. Nëse do të na vihet në dispozicion ajo pjesë e buxhetit ne jemi në gjendje të ecim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, zoti Alibeaj, ta them edhe të fundit, ne jemi në gjendje që për 8 muaj të llogarisim me saktësi nevojat buxhetore aq sa na duhen dhe ne t'i kërkojmë.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – A e di se çfarë po thua, i nderuar? Ti po thua: mirë me vjehrrën, mirë me nusen, nuk shkon! Ta them unë se cila është nusja dhe cila është vjehrra! Institucioni homolog juaji KLGJ-ja ka bërë kërkesën si çdo institucion tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund të mbahet qetësi që ta them këtë gjë? Institucioni homolog KLGJ-ja dhe ata njohës të mirë të ligjit kanë bërë këtë gjë, ata kanë parë që në vitin 2022 ka ndodhur një ngjarje, vetingu i gjyqtarëve. Ata kanë marrë masat, kanë bërë një studim, janë mbledhur me njëri-tjetrin, i kanë bërë kërkesë Ministrisë së Financave, qeverisë.

KLP-ja dhe homologu kanë 11 andej dhe 11 këtej, 6 andej dhe 6 këtej, 5 andej dhe 5 këtej e të tjera, pra jeni homologë, jeni simetrikë, që do të thotë jeni simetrikë edhe në funksione dhe duhet të jeni simetrikë edhe në reagim.

Ju vini këtu dhe thoni këtë gjë: po deshi qeveria të na japë paratë, ne nuk kemi bërë kërkesë. Kjo është. Por të bësh këtë gjë, ju po thoni në një mënyrë tjetër, që nuk keni marrë masat për të zbatuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa të mbarojë zoti Mediu do të them edhe unë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të thotë, një institucion i pavarur siç është KLP-ja, është treguar minimalisht indiferent, neglizhent për të paraqitur kërkesë, a pranohet apo jo është tjetër gjë, pranë qeverisë...

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, ju tërheq vëmendjen! Ju nuk mund t’u drejtoheni me këtë gjuhë institucioneve të pavarura.

Enkelejd Alibeaj – Zonjë, nuk më tërhiqni dot vëmendjen...

Klotilda Bushka – Po, po ju tërheq vëmendjen.

Enkelejd Alibeaj – Jo, vëmendjen, por asgjë nuk më tërheq dot ti, prandaj më lini të mbaroj.

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, nuk mundeni që t’u kërkonit llogari e të intimidoni institucionet e pavarura...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju nuk mund ta bëni dot këtë, sepse sapo më tërhoqët vëmendjen mua për influencim në përgjigje

Enkelejd Alibeaj – Që ta sqaroj këtë histori, ndjesinë e atyre nuk ke se si ta dish ti...

Klotilda Bushka – Ju lutem, po flasim për buxhetin, nuk jeni ju ai që ju ka ngarkuar ligji për të treguar se si po e bëjnë punën ata. Ju jepni komentet tuaja, por nuk mund t’u drejtoheni atyre sikur jeni kontrollori i cilësisë apo i kontrollit.

Enkelejd Alibeaj – Unë jam deputet i këtij Kuvendi dhe u bëj pyetje të gjithë atyre që janë paguar për të bërë këtë punë. Nuk është intimidim.

Klotilda Bushka – Ju lutem, zoti Alibeaj, përfundojeni fjalinë, sepse do ta mbyll dëgjesën.

Enkelejd Alibeaj – Nuk është intimidim, por nëse e ndjeni si intimidim, intimiduohuni, pak rëndësi ka, ajo që po them unë është kjo: ju vjen një ngjarje vitin e ardhshëm, ju nuk keni bërë kërkesë as për para dhe as për buxhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë që ju e keni marrë me mendjelehtësi këtë punë, që është çështja më e rëndësishme e sistemit të drejtësisë, sepse ju sapo e thatë që përditë po boshatiset sistemi i prokurorisë, pra nuk ka prokurorë për shkak të vetingut, i cili duhet të mbarojë një orë e më parë.

Ju thoni, po të dojë qeveria të na i kalojë lekët në vitin 2022, mirë, nëse nuk do, përsëri mirë. Kjo minimalisht tregon mungesë koshience e përgjegjshmërie për pavarësinë e funksionit. KLGJ-ja e bën, ndërsa ju jo. Çfarë dyshohet këtu? A mos ndoshta duhet të aludoj për ndonjë fill të kuq lidhjeje me pushtetin, apo jo? Kush e di, edhe ndodh! Ja, për shembull, me përgjigjen tuaj ju më dhatë mundësi të mendoj që ju paskeni një afilacion me qeverinë. Ma kundërshtoni këtë, më përgënjeshtroini për këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Atëherë, do ta mbyllim këtë dëgjesë. Kuptohet që çdo gjë bëhet për qëllime politike, sepse shqetësimi më i madh në këtë tryeze ishte përse nuk po dalin studentët e 2021, për të plotësuar vakancat për procesin e vetingut.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A e dini përse ndodh kjo, nëse vërtetë jeni të shqetësuar për pavarësinë? Sepse në vitin 2019 unë dhe zoti Manja paraqitëm një nismë ligjore për të pasur më shumë kuota për studentë, që do të dilnin këtë vit, por ju abuzuat me atë të drejtë, nuk firmosët dhe e bojkotuat. Po të kishit shqetësime për vakancat, në atë kohë ju do të ishit me ne, do të kishit pranuar nismën ligjore dhe sot do të kishim studentë që të plotësonim vakancat.

Enkelejd Alibeaj – Nëse keni ndër mend që sistemin gjyqësor ta mbushni me militantë të fondacionit “Qemal Stafa” siç ju doni, kundër do të na keni...

Klotilda Bushka – Ju zoti Alibeaj, tani po i quani militantë studentët e Magjistraturës, ndërsa në dëgjesën e Magjistraturës ju u dhatë vlerë studentëve që dalin nga kjo shkollë. Pra, ju komentet i bëni sipas interesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga zoti Alibeaj.)

Pra, nëse na shqetëson vërtetë efienca e prokurorive dhe e gjykatave, ne duhet të bëjmë atë detyrë që kemi dhe detyra jonë është t’i mbështesim institucionet.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga zoti Alibeaj.)

E kishim mundësinë në vitin 2019, që të kishim studentë sot, por ju nuk e firmosët dhe nuk e miratuat nismën, prandaj jemi këtu sot. Pra, për efekt të konfliktualitetit politik dhe të bojkotit, sot nuk kemi studentë të diplomuar.

(Debate pa mikrofon.)

Faleminderit, zoti Balla, jeni i lirë të shkoni!

Pesë minuta pushim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.11.2021, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me institucionin e SPAK-ut për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”.

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Oerd Bylykbashi, Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Gerta Duraku, Dhurata Tyli, Erisa Xhixho, Gazmend Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Elda Hoti dhe Gledis Çeliku.

Mungojnë:

Damian Gjijnuri, Fatmir Xhafaj, Jurgis Çyrbja, Toni Gogu, Bledion Nallbati, Ermonela Felaj dhe Saimir Hasalla.

Të ftuar:

Arben Kraja – Drejtues i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krijimit të Organizuar.

Mariel Frroku – Drejtori i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financës

Klotilda Bushka – Vazhdojmë mbledhjen me dëgjuesën e Prokurorisë së Posaçme, kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Të ftuar nga ky institucion kemi zotin Arben Kraja, drejtues i strukturës së posaçme.

Mirë se erdhët, zoti Kraja!

Gjithashtu, kemi edhe zotin Mariel Frroku, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financës.

Mirë se erdhët!

Në vazhden e diskutimit të projektbuxhetit të vitit 2022, po bëjmë disa dëgjesa me institucionet e pavarura, në fushë të përgjegjësisë së këtij komisioni në lidhje me nevojat buxhetore dhe nëse këto nevoja janë të plotësuara nga buxheti për vitin që vjen.

Zoti Kraja, ju lutem, mund të na flisni për çështjet që keni nevojë të ndani në këtë komision.

Fjala është për ju.

Faleminderit, zoti Kraja.

Arben Kraja – Faleminderit, zonja kryetare!

Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit për mundësinë që na dhatë për t'u shprehur në lidhje me projektbuxhetin, i cili lidhet me plotësimin e nevojave të institucionit tonë.

Institucioni është i ri, po bëhet viti i dytë që nga krijimi i tij dhe nuk ka funksionuar më përpara në nivel buxhetor, por ka qenë në nivel varësie nga struktura e Prokurorisë së Përgjithshme. Pra, ka qenë një periudhë intensive për ne, për të krijuar struktura të reja dhe për të kuptuar se si funksionon, për të shkuar aty ku duhet të shkojmë.

Megjithatë, për të qenë pjesë e realitetit, ne kemi qenë të përfshirë që në momentet e para, siç e parashikon ligji i buxhetit, pra në mënyrën e hartimit të procedurës, me grupin e punës së krijuar dhe në diskutim të vazhdueshëm me Ministrinë e Financave, ku është arritur të krijohet një draft, i cili është paraqitur këtu.

Ne jemi të kënaqur në parim me atë çfarë është paraqitur, përveç disa gjërave të vogla që mendojmë se mund t'i paraqesim, pastaj është në dorën tuaj t'i pranoni ose jo. Ne kemi dy probleme, të cilat do t'i shtroj këtu, që duhet të marrin zgjidhje.

Problemi i parë është nevoja për një objekt apo ndërtesë për nevojat e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Unë po paraqes nevojat për prokurorinë dhe Byronë Kombëtare të Hetimit, ashtu siç e parashikon ligji.

Byroja Kombëtare e Hetimit është një strukturë e ngritur në varësinë tonë, e cila ka në organikën e saj një numër prej 60 hetuesish, drejtorin dhe 20 vetë që janë në administratë. Pra, është një numër i madh.

Deri tani Byroja ka qenë e përfshirë në objektin ku jemi edhe ne, pra në ish-ndërtesën e Prokurorisë për Krimet e Rënda, e cila është rikonstruktuar totalisht dhe është në gjendje shumë të mirë. Për momentin godina e përballon, sepse Byroja Kombëtare e Hetimit ka 28 hetues nga 60 që duhet të kishte. Por procedura e grupit të dytë të emërimit besojmë se përfundon në dhjetor, do të bëhen edhe 4 muaj trajnim, siç e parashikon ligji, prandaj në muajin maj të vitit që vjen janë 32 hetuesit e tjerë që duhen sistemuar diku, sepse në atë godinë e pamundur t'i sistemohen të gjithë këta njerëz.

Fillimisht me Drejtorinë Ekonomike dhe me strukturat tona krijuam një ide të përgjithshme se sa mund të kushtojë një objekt për ta ndërtuar dhe kërkua një fond, kuptohet në vija të përgjithshme. Në vijim, në diskutime me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me faktorë të tjerë dhe strukturat ndërkombëtare u hodh ideja që është më mirë të gjendet një objekt i gatshëm diku aty afër dhe të bëjmë kërkesë që ta marrim.

Aktualisht, Këshilli i Lartë i Prokurorisë i ka dërguar një letër zyrtare Këshillit të Ministrave, me sa di unë Kryeministrit, ministrit të Drejtësisë, nuk jam i sigurt nëse ka ardhur edhe te ju, pra e ka ngritur si problem dhe ka propozuar 2 ose 3 objekte, që ndodhen rrotull për t'i vendosur në funksion të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

E thënë kjo, ne jemi tërhequr nga kërkesa për fondin. Pra, ideja është që përse të marrim një fond e ta bllokojmë nëse do të gjendet një objekt i gatshëm. Ky është një problem i hapur, i cili duhet të jetë edhe në vëmendjen tuaj për ta zgjidhur vitin që vjen.

Problemi i dytë ka të bëjë me shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ligji parashikon të drejtën që Byroja Kombëtare e Hetimit të ketë shërbime të Policisë Gjyqësore. Çfarë do të thotë? Pra, përfaqësues nga Policia e Shtetit apo policitë të tjera, të cilat rijnë në objektet ku ata janë, por paguhen nga Byroja Kombëtare e Hetimit. Kjo sjell problematikë nga pikëpamja e përcaktimit të numrit dhe fondit, sepse ne kemi përcaktuar një numër (rreth 50) dhe për të hapur garën duhet të kemi një fond në dispozicion. Kjo kërkon që njëkohësisht të ketë fond në dispozicion edhe Prokuroria e Posaçme, edhe Policia e Shtetit, sepse ne nuk e dimë se kur mund të përfundojë gara dhe në momentin kur këtyre njerëzve do t'u ketë përfunduar afati, duhet të rikthehen përsëri në pozicionet ku janë. Nuk mund të rrinë, sepse janë me afat të caktuar. Faktikisht, kjo është një procedurë pak e ngatërruar. Ministria e Financave na e ka dhënë fondin qoftë për numrin e punonjësve që kemi kërkuar, qoftë edhe për shpenzimet për ta. Në këtë kuptim, ne jemi në rregull, por risku është që fondi mund të mos

përdoret totalisht, pra të jetë një fond i bllokuar, sepse i njëjti fond i është dhënë dhe Policisë së Shtetit dhe këta persona duhet të marrin rrogën deri ditën kur mund të vijnë te ne. Kjo është thjesht për ta ditur. Pra, ne jemi dakord me çfarë na ka propozuar Ministria e Financave...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thjesht doja ta prezantoja si problematikë. Është një problematikë e ligjit. Është e pamundur ta zgjidhësh ndryshe.

Për pjesën tjetër pastaj, në raport me numrin e punonjësve, fondin për sigurimet shoqërore dhe të tjerat, jemi në rregull me kërkesat që kemi paraqitur dhe me propozimin që ka bërë Ministria e Financave.

Për sa i përket fondit të investimeve për vitin 2022, na janë ulur 10 milionë lekë në krahasim me vitin aktual. Mendoj se kjo shumë duhet të na jepet përsëri, sepse do të vijë Byroja dhe do të na duhen për pajisje dhe investime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëhet fjalë për 10 milionë lekë të rinj, se po të ishin të vjetër nuk do t'i kërkonim fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Së dyti, në fondin e shpenzimeve kërkojmë të na shtohet një shumë prej 20 milionë lekësh, nisur nga ngarkesat në punë dhe rritja e numrit të punonjësve. Rritja e numrit të hetuesve të Byrosë automatikisht çon në rritje të shpenzimeve operationale që kemi. Po e them pak me humor këtë, por e filluam vitin me idenë që do të na teprojë letra dhe nuk do të dinim ku ta çonim, kur sot drejtori po më thoshte se nuk kemi më letër, sepse ka dy muaj që ka filluar punë Byroja Kombëtare e Hetimit dhe është rritur në mënyrë të jashtëzakonshme fluksi i aktivitetit. Kjo ishte në vija të përgjithshme. Për pjesën tjetër nuk e di nëse ka pyetje.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Kraja!

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe relatori a kanë diçka për të shtuar për këto kërkesa?

Po, zoti Bllako.

Alqi Bllako – Faleminderit, zonja kryetare!

Siç e përmendi dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ka një shtim të numrit të punonjësve të kësaj prokurorie, për shkak të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Rrjedhimisht, kjo është shoqëruar dhe me një dyfishim të fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore. Sigurisht që, siç e përmendi me të drejtë dhe zoti Kraja, ky dyfishim nuk është shoqëruar me një rritje progresive të logjikshme për shpenzimet operative, pasi ndërkohë që kemi një shtim të numrit të anëtarëve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, rritja në zërin e shpenzimeve operative është

krejtësisht minimale dhe mendoj se është e pamjaftueshme për të mbuluar aktivitetin e plotë operacional të kësaj strukture. Ndaj mendoj se kërkesa është e arsyeshme dhe duhet mbështetur kjo shtesë në zërin nr.602 “Mallra dhe shërbime” dhe, rrjedhimisht, duke qenë se në parim jemi pro kësaj shtese, në momentin kur ky staf do të jetë në detyrë dhe në funksion, pa diskutim që për të kryer detyrën, ashtu siç e kërkon ligji, do të duhet të jetë i pajisur edhe me pajisjet e nevojshme. Ndaj mendoj se bën sens dhe logjikë edhe kërkesa për të mos prekur zërin e investimeve në raport me nivelin e miratuar për tavanin buxhetor të vitit 2021.

Duke e përmbledhur, jam dakord me të dyja propozimet, pasi çështja e godinës kishte marrë një tjetër zgjidhje për momentin, edhe për shtesën e zërit për shpenzime, mallra e shërbime, në mos gaboj, në vlerën 22 milionë lekë, edhe për vlerën e investimeve.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Bllako!

Kuptoj që çështja e pajisjeve dhe e mjeteve duhet rifatur në buxhet, pra shuma prej 10 milionë lekësh. Fondi për shpenzimet operationale duhet të shtohet për efekt të shpenzimeve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Pra, Struktura e Posaçme nuk vjen këtu vetëm për prokurorinë, le të themi, ka dy degë, prokurorinë dhe Byronë. Kështu që këtu përfaqësohen nevojat buxhetore të të dyja zyrave brenda institucionit. Këto duhet të referohen në projektbuxhet dhe në relacionin tonë, sa u takon sugjerimeve që i japim komisionit përgjegjës. Ndërkohë, me sa kuptoj, çështja e godinës është dakordësuar për një zgjidhje tjetër, pra të gjendet një ambient, të jepet me qira, të rikonstruktohet apo të jepet në përdorim. Kjo është një çështje që po ndiqet në vijimësi me Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Ne do të interesohemi si komision, nëse kjo letër ka ardhur dhe te ne, dhe do të ndjekim zbatimin e kësaj zgjidhjeje.

Edhe unë jam dakord që një fond i ri për të ndërtuar një godinë të re, edhe nëse do të ishte një gjë që i shërben institucionit në afatgjatë, do të kërkonte kohë. Ndërkohë, nevojat për shtesë personeli do t’ju mbulohen menjëherë. Kështu që ju keni nevojë për mjedise dhe të filloni menjëherë punën. Prandaj them që këtë zgjidhje që keni gjetur, edhe ne, si komision, duhet ta shtymë para, që të realizohet sa më shpejt. Besoj se anëtarët e komisionit janë të gjithë dakord ta ndjekim këtë çështje. Kjo nuk është çështje e buxhetit.

Ndërkohë, zonja Çausholli, për çështjen e fondit për shërbimet e Policisë Gjyqësore, që është në dy buxhete, edhe të policisë, edhe të SPAK-ut, a mund të kemi një sqarim?

Vilma Çausholli – Faleminderit!

Në lidhje me përcaktimet ligjore për oficerët e Policisë Gjyqësore ka një parashikim, ku thuhet që këta oficerë mund të merren nga BKH-ja, më falni nëse nuk e them saktësisht, por, njëkohësisht, me përfundimin e punës apo të periudhës për të cilën merren nga BKH-ja,

do të duhet të rikthehen në strukturat ku ata janë tërhequr më parë, në Policinë e Shtetit apo në ndonjë strukturë tjetër ku mund të jetë OPGJ-ja.

Duke pasur diskutime për mënyrën se si do të procedohet teknikisht, ne kemi hasur vështirësi dhe prandaj jemi munduar të plotësojmë detyrat dhe përgjegjësitë me burime financiare e burime njerëzore të BKH-ës, me qëllim që të vazhdojë veprimtarinë e saj, duke i parashikuar fondet edhe të struktura e BKH-së, pra e SPAK-ut. Buxheti i Policisë së Shtetit është i konsiderueshëm dhe numri i punonjësve është i përfshirë njëkohësisht edhe në buxhetin e Ministrisë së Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Kështu që mund të bëhet një alternativë e numrit të punonjësve dhe të fondeve përkatëse. Për të shmangur procedurat që duhet të bëheshin me vendim të Këshillit të Ministrave, ne kemi parashikuar që BKH-ja t'i ketë në dispozicion këto burime, në mënyrë që të mos pengohet veprimtaria e saj. Shpresojmë që edhe nga Ministria e Brendshme të mos ketë ndonjë kontestim në lidhje me përcaktimin e këtyre burimeve njerëzore dhe financiare pranë BKH-së.

Klotilda Bushka – Pra, nuk kemi akoma një qëndrim të Ministrisë së Brendshme për këtë çështje? Se duhet ta ezaurojmë dhe të mos e lëmë një çengel të varur. Duhet zgjidhur kjo gjë.

Vilma Çausholli – Për momentin nuk kemi ndonjë kontestim nga Ministria e Brendshme.

Klotilda Bushka – Po, zoti Kraja.

Arben Kraja – Nuk ka arsye pse të ketë kontestim, sepse Ministrisë së Brendshme nuk i është prekur buxheti, as numri i punonjësve, as fondi. Këtu diskutohet që kemi një dublim për një kategori të caktuar njerëzish, ku ne marrim dhe numrin e punonjësve dhe fondin, por nuk e përdorim, sepse duhet bërë konkurrimi, gara dhe dikush mund ta kalojë e dikush jo. Kur t'i marrim këta persona, atëherë do të paguhen nga ne, nga fondi që kemi. Kështu që për mua, në këtë kuptim, Ministria e Brendshme nuk ka ndonjë problematikë dhe nuk duhet të ketë.

Klotilda Bushka – Zoti Kraja, për ju, mënyra se si është parashikuar në buxhet ky zë, është e zbatueshme? A krijon ndonjë problem në praktikë? A ka nevojë për ndonjë zgjedhje tjetër apo është e realizueshme?

Arben Kraja – Për mua është krejtësisht e zbatueshme. Ne nuk e bënim dot në këtë vit, sepse nuk kishim numër punonjësish dhe nuk mund të hapja garën për shërbime pa pasur numër punonjësish. Me këtë jam në rregull dhe...

Klotilda Bushka – Atëherë, është e qartë, është e parashikuar në buxhet dhe ju mund ta realizoni. Në rregull.

Arben Kraja – Kam edhe diçka, meqenëse e mora fjalën.

Klotilda Bushka – Po, patjetër.

Arben Kraja – Në raport me kërkesën për investime apo fonde, jemi munduar të jemi sa më realistë dhe të përdorim të gjitha burimet e mundshme. Gjatë këtij viti kemi marrë nga fondi i konfiskimeve, pra nga konfiskimet në proces penal apo nga konfiskimet në bazë të ligjit antimafia, një shumë rreth 30 milionë, me anë të së cilës kemi ngritur laboratorin e ekspertimeve, që është një ndër laboratorët më të mirë elektronikë që ka rajoni.

Po kështu, kemi marrë donacion nga ICITAP-i për ngritjen e sistemit të serverëve.

Kështu që jemi munduar të mos e rëndojmë shumë buxhetin, duke i shfrytëzuar të gjitha aftësitë dhe mundësitë që na jepen, kuptohet, të gjitha këto brenda procedurave ligjore që na jepen.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Kraja!

Në fakt, edhe në dëgjesat e mëparshme, kur institucionet kanë pasur nevoja, kryesisht edhe për mjete, edhe me zotin Deliu, por edhe me zotin Bylykbashi gjithmonë kemi diskutuar mundësinë që institucionet të përdorin pasuritë e konfiskuara. Më vjen mirë që ju e paskeni vënë në përdorim këtë pasuri për efekt të mbulimit të nevojave të institucionit, sepse kështu përdorim dhe të gjitha burimet materiale që ka shteti për institucionet, në mënyrë që të realizohen më së miri funksionet.

Kush e do fjalën nga kolegët? Zoti Alibeaj dhe zoti Sula.

Fjalën e ka zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit!

Në parantezë, deputetët e këtij krahu janë të gjithë dakord për të përmbushur të gjitha kërkesat që ka SPAK-u.

Me çfarë dëgjova nga sqarimet që dhatë, ju jeni të kënaqur me buxhetin. Çështja e godinës së BKH-ës është një çështje që nuk e zgjidhim ne, pavarësisht dashamirësisë tonë. Kjo është një çështje që e zgjidh vetëm qeveria, e cila ka listën dhe inventarin e të gjitha ndërtesave e pasurive shtetërore; nëse do, e jep; nëse nuk do, nuk e jep po të doni ju, por thjesht për pyetje, kur të merrni fjalën, do të doja të dija prej sa kohësh i keni dërguar kërkesë qeverisë për t'ju dhënë godinën e identifikuar nga ju, në mënyrë që të investoni për të bërë shtëpinë e re të BKH-së? Po pyes për të parë reaktivitetin apo konstruktivitetin e qeverisë.

Ne mund ta bëjmë këtë. Nëse na e jepni këtë të dhënë, çdo ministër, akoma më mirë nëse është ministri i Drejtësisë, do ta marrë si kërkesë të parë nga deputetët e këtij krahu. Këtë presion pozitiv ne mund ta bëjmë dhe do ta bëjmë.

U sqarua që ju i keni fondet për çështjen e shërbimeve të Policisë Gjyqësore, pra nuk keni mangësi; ngelet vetë procedura për t'i rekrutuar ata.

Së treti, në fillim të fjalës suaj thatë se jeni plotësisht dakord me kërkesat e buxhetit dhe me parashikimet që keni bërë.

E keni parashikuar funksionin shtesë të komisionerëve publikë që do të merrni në vitin 2022 në kuadër të vetingut?

Do të flas shkurt, edhe për publikun. Ju e dini që me kalimin e 5 vjetëve përfundon mandati, e drejta, jo procesi i vetingut i KPK-së, i atyre që bëjnë shqyrtimin në instancë të parë, por edhe i komisionerëve publikë, që bëjnë ankimet eventuale dhe funksioni i dytë i komisionerëve publikë i kalon SPAK-ut, i cili bëhet pjesë e plotë e integruar e procesit të vetingut. A keni bërë analizë dhe a keni paraqitur kërkesë për Ministrinë e Financave për sa i përket volumit të punës që ju shtohet? Çfarë mbështetje financiare ju duhet dhe çfarë përgjigje ju kanë kthyer?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zoti Kraja.

Arben Kraja – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Procesi është iniciuar nga unë dhe nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit. Në fund të muajit shtator i është dërguar Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Nga informacionet e mia, kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë i është drejtuar Kryeministrit, ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Bashkisë së Tiranës më 28 tetor, duke iu propozuar 3-4 objektet dhe jemi në pritje të një komunikimi të vazhdueshëm. Unë jam në kontakt me Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Nuk jam futur unë drejtpërdrejt, por Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sepse ata na menaxhojnë nga pikëpamja financiare dhe e administrimit.

Për pyetjen e dytë, është e vërtetë, sepse është parashikim ligjor: me përfundimin e mandatit të komisionerit publik, funksionin e komisionerit e zëvendëson drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Automatikisht, Prokurorisë së Posaçme do t'i shtohet edhe një nga detyrat e caktuara me ligj të prokurorit, siç e thotë edhe Kushtetuta. Nuk kemi bërë llogaritje apo propozime. Mendimi im është se ajo strukturë është ekzistuese, funksionon, është në ecuri e sipër dhe nuk i mbaron mandati më 1 janar, por diku nga gjysma e vitit, kurse nga pikëpamja teknike për mua është e zgjidhur. Fondi, që është në dispozicion të tyre, duhet të kalojë në dispozicionin tonë, me numrin e punonjësve administrativë ku janë, sepse ne nuk kemi vende në zyrat ton. Pa diskutim, do të kërkohet paraprakisht një studim paraprak i strukturës, i nevojës, sepse mund të mos kemi nevojë për të gjithë, mund të kemi nevojë për më pak apo më shumë, kjo është histori tjetër, por duhet një periudhë përgatitore, para se të mbarojë afati. Për mua nuk ka problem.

Enkelejd Alibeaj – Duhet të sqaroj diçka që doli nga shpjegimi juaj.

Kur keni përgatitur buxhetin, ju keni bërë analizën tuaj për funksionet tuaja të pritshme, hetimin apo funksionet e tjera me ligj. Në pasazhin tuaj të fundit ju po thoni se, meqenëse ato janë të parashikuara nga qeveria, nga Ministria e Financave, te organet e vetingut, mendoni se në mënyrë të natyrshme, diku nga data 17 qershor, do të vijnë te ju. Pra, ju keni gjykuar se nuk ka nevojë për kërkesë, por unë po ju them se qeveria ka parashikuar se fondi për të gjithë vitin, nga 18 qershori e në vazhdim të jetë te vetingu. Ju nuk keni bërë kërkesë për një funksion që ju vjen. Këtyre u leverdis.

E para: kush do ta bëjë vetingun më 18 qershor, në mungesë të një kërkesë?

E dyta, ju e thatë me të drejtë se duhet bërë një studim. Po ju them një fakt: Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka bërë këtë studim në prill të këtij viti për pjesën që i takon procesit të vetingut, dhe në gusht, siç janë rregullat e buxhetit, i ka bërë kërkesë: “Presim që në qershor të vitit 2021 të vijë një funksion; duhen njerëz dhe 30 milionë lekë”. Pra, i kishin llogaritur të gjitha dhe kishin bërë kërkesën e tyre. E pritshme, duke qenë se ligji është i njëjtë, funksioni është po i njëjtë, por duhet të ishte edhe sjellja juaj. Funksioni juaj mund të jetë shumë i vogël, sepse janë dy komisionerë publikë, por duhej bërë një kërkesë formale, ndryshe, më lejo komentim, do të thotë se ose ju nuk keni parashikuar funksionet tuaja dhe buxhetin, dhe kjo shenjë nuk tregon energji të të qenurit strikt me ligjin; ose konsiderohet si një neglizhencë. Neglizhenca, në këto raste, ka një kosto të madhe, sepse do të thotë se në momentin kur funksioni vjen për t’u kryer, institucioni nuk është gati. Problemi është për ata që e pësojnë nga procesi i vetingut. Ky është merak im, për t’ua vënë në dukje, sepse ky është momenti. Kur vendoset për çështjet e buxhetit, nuk mblidhet më parlamenti për këto çështje. Mund ta bëni kërkesën nga fundi i vitit dhe përgjigjen që do t’jua japë qeveria, me të drejtë, do të jetë: pse nuk u kujtove kur duhej, vitin e kaluar? Pra, nëse është neglizhencë, dakord, por nëse keni menduar se do të mendojë qeveria për vetingun, ka edhe një problem tjetër, që ka të bëjë me aparencën, me mënyrën se si trajtohet një nga proceset më të rëndësishme, i cili duhet të jetë politikisht i painfluencuar.

Ju solla këto fakte. Më pas, është e drejta juaj të reagoni për to.

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, ju lutem, jini të kujdesshëm me komentet paragjykuese për institucionet e pavarura! Jua thashë edhe herën e kaluar!

Enkelejd Alibeaj – Zonjë, më lejoni 30 sekonda!

Klotilda Bushka – Jo, nuk ju lejoj, sepse ju kam lënë shumë sekonda.

Enkelejd Alibeaj – Më lejoni 30 sekonda, sepse ...

Klotilda Bushka – Fjalën e ka kërkuar relatori, zoti Bllako.

Enkelejd Alibeaj – Para se të flasë Bllako, se nuk po shikoj nga ata, ju lutem, zonjë, bëjeni edukatë ju dhe kushdo tjetër, e drejta e deputetit për të folur, është e pakufizuar. Të vetmit ata, që gjykojnë, janë ata që dëgjojnë. E pacencurueshme.

Mos u vendosni ju në mbrojtje të institucioneve të pavarura, sepse bëni të njëjtën gafë, siç po ma faturoni mua.

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj!

Ju kam thënë edhe një herë tjetër ...

Enkelejd Alibeaj – Ju lutem, zonjë!

Klotilda Bushka – Ju nuk jeni personi që keni gjykimin më të drejtë.

Enkelejd Alibeaj – Se kush jam unë ...

Klotilda Bushka – Ju tërheq vëmendjen në kuadër të respektit të pavarësisë së institucioneve dhe në kuadër të Rregullores!

Enkelejd Alibeaj – Historinë e tërheqjen së vëmendjes, sepse ma ke përsëritur dy herë, mos e përdor më!

Klotilda Bushka – Zoti Bllako, keni kërkuar fjalën.

Enkelejd Alibeaj – Mos e përdor më me asnjë nga deputetët, sepse nuk je ti që vendos këtu tërhiqet vëmendja apo jo!

Tregohuni më serioze!

Respektoni të drejtën e deputetëve!

Fjala është arma e vetme që kanë deputetët.

Mos e censuroni atë, sepse nuk keni të drejtë, mbi të gjitha!

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, mund ta marrë fjalën zoti Bllako?

Enkelejd Alibeaj – Jo, nuk do ta marrë fjalën, sa të mbaroj unë.

Klotilda Bushka – Ju e mbaruat fjalën.

Enkelejd Alibeaj – Nuk e merr fjalën zoti Bllako, pa mbaruar unë, sepse ne duhet të vendosim këtu, me konstruktivitet, me rregulla, respektin për njëri-tjetrin, dhe respekti është koha për të folur. Se çfarë tonaliteti përdor, se çfarë epitetesh përdor, se çfarë morfologjie dhe semantike përdor, është çështja ime. Ata që vijnë aty, të varur apo të pavarur, politikë apo jo vijnë në derën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ku duhet të japin llogari për faktin se, mirë apo keq, ne jemi votuar. Duhet ta pranojmë të gjithë këtë gjë. Askush nuk intimidohet në parlament. Përkundrazi, në parlament duhet të vijnë për të gjetur mbështetjen ligjore dhe kushtetuese, dakord? Ky të jetë leksion edhe për ne, për të mos i ndërhyrë njëri-tjetrit.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Nuk jam dakord, por gjithsesi, ju keni mendimin tuaj.

Unë do të vazhdoj të zbatoj Rregulloren dhe, për dijeninë e të gjithë kolegëve, po ju them edhe një herë se institucionet nuk vijnë këtu të japin llogari. Institucionet e pavarura janë të pavarura.

Enkelejd Alibeaj – Sigurisht.

Klotilda Bushka – Llogari kërkojuni atyre që keni për detyrë jo institucioneve të pavarura.

Zoti Bllako, mund të bëjmë një sqarim për çështjen e buxhetit të procesit të vetingut?

Alqi Bllako – Faleminderit, zonja kryetare!

Nuk jam në dijeni të korrespondencës shkresore midis institucioneve dhe Ministrisë së Financave.

Me garanci të plotë mund të them se për sa u përket funksioneve të parashikuara nga komisioneri publik, zëri është buxhetuar i plotë për të gjithë vitin 2022 për këtë funksion dhe në momentin që parashikon Kushtetuta, më 17 qershor 2022, nëse ky funksion do të transferohet në një institucion tjetër, i gjithë zëri buxhetor do të transferohet bashkë me funksionin.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zoti Kraja, një fjalë të fundit.

Arben Kraja – Nga pikëpamja teknike, për mua nuk ka asnjë problematikë, sepse është shumë e thjeshtë për t'u zgjidhur.

Për faktin pse nuk është propozuar, ne jemi duke diskutuar, nuk po analizojmë një ligj, ne po diskutojmë, por, nëse ju e mendoni se duhet bërë, ju jeni deputetë dhe mund ta bëni, unë e prezantova si problematikë. Pra, mund ta ndryshoni dhe të vendoset që tani në fondin e buxhetit të institucionit tonë që të fillojë në muaji qershor.

Klotilda Bushka – Këto janë rregulla buxhetore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Kraja – Në momentin që mbyllet ka një rregull buxhetor. Pra, kur mbyllet një institucion dhe transferohet diku tjetër, transferohet i gjithë fondi bashkë me numrin e punonjësve. Kjo është çështje e zgjidhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti deputet, nuk e kam detyrë unë të bëj kërkesë, nuk e mbyll unë institucionin, e mbyll parlamenti.

Klotilda Bushka – Zoti Kraja, faleminderit!

Zoti Sula.

Dashnor Sula- Faleminderit!

E dëgjova me shumë vëmendje drejtuesin e SPAK-ut dhe gjej rastin ta falënderoj për mënyrën si mendon dhe si do të organizohet puna sa i përket e BKH-së, sepse është shumë e rëndësishme! Duke marrë shkas nga shpjegimi që bëri zoti Kraja për përdorimin e fondeve nga sekuestrimi i pasurive të organizatave kriminale për ngritjen e një laboratorit shumë të rëndësishëm në funksion të SPAK-ut, si dhe për përgjegjshmërinë e treguar nga drejtuesi i SPAK-ut dhe e gjithë struktura, pasi tha se janë munduar të respektojnë dhe ndihmojnë buxhetin me një përgjegjshmëri totale, të lartë. Unë i përgëzoj, por shpresoj të kenë të njëjtën qasje edhe qeveria, edhe institucionet e tjera, të cilat janë pranë qeverisë, sepse buxheti i shtetit, në shumicën e rasteve, shikohet si një mjet, me të cilin abuzohet në mënyrë skandaloze. E thashë këtë gjë, duke pasur parasysh se jeni organi qendror, kryesor, që mund të bëni të mundur parandalimin e një abuzimi të tillë ose të ndëshkoni ata drejtues ose persona që bëjnë shkelje dhe abuzojnë me paratë e taksapaguesve shqiptarë.

Gjithsesi, duke pasur parasysh kapacitetet profesionale që do t'i keni nga tani e tutje, edhe me strukturën e BKH-së, që do të jetë funksionale, mbetem me shpresë se Presidenti, Kryeministri, ministrat dhe deri te drejtuesi më i fundit do t'i plotësojnë detyrimet kushtetuese, por nëse abuzojnë me fondet e shteti, duhet të jenë në bankën e të akuzuarve. Jo se ju keni shkopin magjik, si strukturë, por është shumë e rëndësishme të paktën për gjërat që janë të dukshme, të denoncuar nga qytetarët, ose nga opozita, ose kushdo qoftë, KLSH-ja, të jemi më të përgjegjshëm. Unë mendoj se kjo do të jetë një gjë shumë e mirë dhe në interes të vendit.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Sula!

Zoti Deliu.

Denis Deliu – Faleminderit!

I nderuar kryetar i SPAK-ut, ndihem shumë i lumtur për ato që dëgjova nga ju për krijimin e një laboratorit ekspertimi, më të mirin në Ballkan, dhe ende më i lumtur që ky buxhet është marrë nga konfiskimet, sipas ligjit të antimafies për konfiskimet. Unë si deputet i maxhorancës ju them me bindje të plotë se do të keni mbështetjen tonë maksimale për çdo nismë ose projekt që ju do të keni për të përmirësuar dhe arritur objektivat që keni në punën tuaj.

Kam një pyetje për godinën që ju kërkoni për BKH-në, a keni përcaktuar kritere sigurie për godinën? A do të keni nevojë për siguri për mbrojtjen e kësaj godine? BKH-ja do të ketë nevojë për një mbrojtje shtesë nga shumë fusha, e them këtë edhe si një ekspert i sigurisë.

Klotilda Bushka– Po, zoti Kraja.

Arben Kraja – Faleminderit!

Jemi në fazën e identifikimit të objektit, për të cilin ka disa kriterë, të cilat ne i kemi vendosur. Kriteri i parë është të jetë sa më afër objektit që ne kemi, për arsyen e thjeshtë se ne jemi një strukturë e vetme, një trupë e vetme dhe duhet të jemi bashkë, sepse është në të mirën e punës kjo. Nëse do të fillojmë të krijojmë një strukturë këtu, ndërsa BKH-të ta çojmë në Vaqar, do të shkatërrohej i gjithë koncepti për të cilin është ngritur nga ju kjo strukturë. Pra, po mundohemi të jemi afër. Patjetër, në momentin që do të identifikohet objekti, që të jetë sa më ngjitur me objektin ku jemi ne sot, do të ketë nevojë pastaj për të përcaktuar mënyrën si do të lidhet komunikimi, ruajtja e të tjera me radhë. Nga pikëpamja ligjore janë të parashikuara të gjitha, sepse ligji parashikon se BKH-ja edhe SPAK-u ruhen nga strukturat e Policisë së Shtetit. Pra, janë të gjitha procedurat e përcaktuara, por ka gjëra që do të zgjidhen në vijim. E rëndësishme për mua është sa më shpejt të identifikohet objekti, por ju kërkoj falje, se nuk është puna juaj për ta zgjidhur këtë problem.

Klotilda Bushka - Faleminderit, zoti Kraja!

Në përmbyllje të diskutimeve mendoj se Ministria e Financave dhe relatori duhet të adresojnë çështja e shpenzimeve operative dhe çështja e fondit të shpenzimeve për shpenzime operacionale, investimet pra, më falni mua për temat e buxhetit, pra për pajisje dhe mjete për të ushtruar punën dhe shpenzimet operacionale që hyjnë në shpenzimet në mbështetje të veprimtarisë së përditshme. Pra, këto dy zëra duhen adresuar, ndërsa çështja e ndërtesës nuk është në kompetencë të këtij komisioni, por ne, në kuadrin e koordinimit të institucioneve, mund të interesohemi që kjo gjë të marrë një shtysë dhe të realizohet sa më shpejt. Do të mbajmë kontakt më KLP-në, meqë e paska dërguar kërkesën në institucionet përkatëse.

Zoti Kraja, faleminderit për prezencën këtu! Jeni gjithmonë i mirëpritur. Nëse keni diçka të fundit mund ta thoni.

Arben Kraja – Faleminderit! Nuk kam asgjë më shumë. Mirë u takofshim!

A mund të largohemi?

Klotilda Bushka- Po, mund të largoheni tani.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.11.2021, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka– kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”.

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Oerd Bylykbashi, Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Gerta Duraku, Dhurata Tyli, Erisa Xhixho, Gazmend Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Elda Hoti dhe Gledis Çeliku.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Fatmir Xhafaj, Jurgis Çyrbja, Toni Gogu, Bledion Nallbati, Ermonela Valikaj(Felaj) dhe Saimir Hasalla.

Të ftuar:

Dëshira Pasko – Sekretare e Përgjithshme në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë

Isida Koka- Këshilltare në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë

Klotilda Bushka - Do të vazhdojmë me dëgjesën e radhës, është Inspektorati i Lartë i Drejtësisë.

Nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen zonja Dëshira Pasko, sekretare e Përgjithshme, zonja Isida Koka, këshilltare. Ju ftojme të zini vendet!

Zoti Artur Metani, inspektor i lartë, është njoftuar për të qenë në dëgjesë javën e kaluar, njësoj si kreu i KLP-së, por ne e shtymë atë mbledhje. Këtë javë, siç ju thashë, të gjithë krerët e institucioneve të drejtësisë janë ë një takim zyrtar, me ftesë të qeverisë gjermane, prandaj zonja Pasko është paraqitur në cilësinë e saj si sekretare e Përgjithshme, në emër të ILD-së, por ILD-ja ka sjellë edhe një shkresë për konsultimin e buxhetit për vitin 2022.

Meqë zonja Pasko është këtu, fjala është për ju, zonja Pasko, nëse nevojat e institucionit mbulohen nga buxheti i vitit 2022 dhe nëse keni ndonjë gjë për të thënë.

Fjala për ju.

Dëshira Pasko –E nderuar kryetare e komisionit,

Të nderuar anëtarë,

Duke ju falënderuar për ftesën e dërguar pranë zyrës së ILD-së, në kuadër të realizmit të dëgjesave me institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, për të dëgjuar dhe diskutuar dhe çështjeve dhe problematikave që prekin këtë institucion!

Gjatë shqyrtimit të një projektligji kaq të rëndësishëm, siç është projektligji për buxhetin, më poshtë po vijoj me disa sqarime në lidhje me realizmin e projektbuxhetit të vitit 2021, dhe kërkesat për vitet 2022 dhe 2023.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një institucion i krijuar rishtazi, si pjesë i institucioneve të reformës në drejtësi. Si një institucion i ri kushtetues dhe ligjor, i cili u konstituua më 1 shkurt të vitit 2020, pas zgjedhjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, menjëherë pas konstituimit ka filluar dhe ka ushtruar funksionet e tij. Në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore...

Klodiana Bushka – Zonja Pasko, më falni që ju ndërpres, por përmbledheni fjalën tuaj në lidhje me nevojat buxhetore, sepse sa i takon punës së institucionit ne do të kemi raportimin vjetor të inspektoratit. Vetëm sot do të flasim për nevojat buxhetore të institucionit.

Dëshira Pasko – Atëherë, nevojat buxhetore të institucionit për vitin 2022-2023, referuar materialit të depozituar nga Këshilli i Ministrave në Kuvendin e Shqipërisë në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022” për zyrën e ILD-së është parashikuar detajimi i shpenzimeve si më poshtë: për vitin 2022 është parashikuar në total buxheti prej 266,8 milionë lekësh, nga i cili për shpenzime korrente është në vlerën 202,8 milionë lekë, për investime është 64 milionë lekë.

Kërkesat e zyrës së ILD-së janë marrë parasysh dhe janë reflektuar në projektbuxhetin e paraqitur dhe akomodojnë një pjesë të konsiderueshme të nevojave të buxhetit të ILD-së. Në zërin e investimeve janë përfshirë këto projekte: projekti i rikonstruksionit të ambienteve për godinën e ILD-së, me një vlerë totale prej 110 milionë lekësh, realizim i cili parashikohet të përfshijë rreth 2 vjet buxhetorë, pra shtrihet në një kohë rreth 14 muaj; për blerjen e pajisjeve dhe mobilimin e zyrave është miratuar fondi prej 3 milionë lekësh, për blerje pajisjesh kompjuterike është miratuar fondi prej 1 milionë lekësh. Për vitin 2023 në total buxheti është 247 milionë lekë, nga i cili për shpenzime korrente 195 milionë lekë, për investime 52 milionë lekë, ku përfshihet edhe fondi prej 50 milionë lekësh, parashikuar për vazhdimin e punimeve për rikonstruksionin e godinës. Për vitin 2024 në total buxheti është 197 milionë lekë, nga i cili për shpenzime korrente janë vetëm 195 milionë lekë dhe për investime 2 milionë lekë.

Parashikimi në projektbuxhetin e paraqitur i mbulon nevojat e institucionit, kemi rakorduar dhe jemi në përputhje të plotë me kërkesat që kemi dhe parashikimet që ka bërë Ministria e Financave.

Klotilda Bushka- Faleminderit!

Në fakt, edhe në shkresën dërguar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është i njëjti qëndrim, kështu që kalojmë te pyetjet.

Nëse nuk keni nevoja shtesë, unë nuk po ua jap fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe relatorit..

A ka pyetje nga kolegët?

Zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Me sa kuptova, ju jeni të kënaqur me kërkesat dhe plotësimin e tyre.

Unë kam një pyetje për të kuptuar sa ka qenë këtë vit realizimi i buxhetit për vitin e kaluar, pra për vitin 2020, deri në çfarë mase është përdorur?

Dëshira Pasko – Realizimi i buxhetit deri në fund të vitit 2021, pra realizimi i pritshëm, është në masën 65,8%. Relativisht është një shkallë e ulët e realizimit të buxhetit në vit dhe kjo vjen për dy arsye.

E para, janë pozicionet vakante që ka pasur institucioni në lidhje me pozicionet e punës si inspektor magjistrat dhe jomagjistrat, pasi aktualisht në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë ka vende vakante për këto 2 pozicione. Pra, këto vende vakante kanë sjellë një vlerë prej 28 milionë lekësh si mosrealizim të buxhetit.

E dyta, është mosrealizimi i projektit për rikonstrukcionin e godinës, duke qenë se vlera e vënë në dispozicion për rikonstrukcion ishte më e ulët se vlera që doli nga preventivi i projektit.

U ra dakord me Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Financave që ky fond të kalonte për vitet 2022 dhe 2023.

Enkelejd Alibeaj – Nuk po merrem me investimin, sepse është një gjë që ndodh, por po merren me çështjen e vendeve vakante, se që nga ngritja si institucion një nga problemet që ka pasur është plotësimi i vendeve vakante, për ata që dëgjojnë e nuk kuptojnë mirë, do të thotë se nuk ka inspektorë për të hetuar.

Pyetja që unë kam, duke qenë se kjo është një ndër plagët më të mëdha që ka Inspektorati i Lartë i Drejtësisë është: çfarë është ndërmarrë nga ana e ILD-së në mënyrë që vendet vakante të plotësohen? Çfarë është bërë, çfarë inventivi është ndërmarrë nga ILD-ja? Sepse nëse vendet janë vakante, ju nuk hetoni magjistratët dhe po nuk hetuat dot magjistratët, ata nuk duan t'ia dinë. Nuk është intimidim ky, por sjellje në vëmendjen e njerëzve e një problemi të madh që ka Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, i cili nuk ka njerëz, nuk ka inspektorë, inspektimet nuk bëhen dhe për sa kohë që nuk bëhen inspektime, ata magjistratët shinë prokurorë apo gjyqtarë qofshin. Ky është viti i tretë, kam përshtypjen, që institucioni i dytë është ngritur dhe nuk mund të shitet, sepse e kam dëgjuar, si sukses. Sa ankesa kanë ardhur? Numri i madh i ankesave që kanë ardhur dhe që janë depozituar tregon të kundërtën, pra tregon dështimin dhe ky është një ndër problemet më të mëdha që ka ky institucion.

Unë këtë do të doja të dija prej jush. Ndoshta nuk jeni ju personi i duhur duhet të ishte vetë inspektori, gjithsesi do të doja një përgjigje cilado qoftë ajo.

Klotilda Bushka – Zonja Pasko, shqetësimi është në lidhje me plotësimin e vakancave. Ju keni një strukturë, të cilën keni arritur ta plotësoni me një numër të caktuar, por keni ende vakanca, të cilat janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve. Keni bërë procedura nuk ju kanë ardhur njerëz, keni masa që duhet t'i merrni, në fakt është e rëndësishme si çështje.

Dëshira Pasko – Më duhet t'ju them se zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është kompletuar pothuajse 100% sa i takon statusit të nëpunësit civil, pasi pozicionet e punës janë me status të nëpunësit civil, por ka mangësi për inspektorët magjistratë dhe jomagjistratë. Ajo çka mund të bëjë ligjërisht zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këto raste është që për vitin 2020 janë të paktën 6 kërkesa të përsëritura ndaj komisioneve, kryesisht KLGJ-së, për shpalljen e komandimit për inspektor magjistratë pranë zyrës së KLGJ-së, por që të gjashta kanë dështuar dhe ende nuk kemi inspektor magjistratë. Kjo kryesisht ka ardhur si rezultat i mungesës së interesit të magjistratëve për të aplikuar dhe për t'u komanduar si inspektor.

Njëkohësisht, mund t'ju them që ne aktualisht jemi në procesin e plotësimit të vendeve vakante për 9 inspektorë jomagjistratë. Procedura ka filluar ligjërisht, por referuar procedurave të parashikuara nga ligji dhe nga VKM-ja, janë procedura që zgjasin, jemi në proces dhe shpresojmë që në fund të procesit do t'i kemi të 9 kandidatët që do t'i plotësojnë kushtet për t'u emëruar si 9 inspektorë jomagjistratë pranë ILD-së.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Pasko!

Mendoj se e kemi ezuaruar dëgjuesën me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Faleminderit, zonja Pasko që ishit e pranishme!

Jeni e lirë të shkoni.

Do të vijojmë dëgjuesën me institucionin e fundit për sot, Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil. Ftoj komisioneren, zonjën Pranvera Strakosha, të zërë vend.

Mirë se erdhët, zonja Strakosha!

Zonja Strakosha është e shoqëruar nga zonja Arbana Basha, drejtore e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe zonja Ollga Hodaj, drejtore e Financave dhe e Shërbimeve Mbështetëse.

Dëgjuesën që kishim me ju ditën e hënë e shtymë për arsye shëndetësore që ju kishit. Ju urojmë të shkuara!

Ndërkohë, siç jeni edhe në dijeni, sot kemi seancën e dëgjuesës me institucionin tuaj në kuadrin e shqyrtimit të projektbuxhetit 2022. Ju keni të drejtën të shprehni nëse nevojat tuaja mbulohen nga ky buxhet dhe në bazë të prioritizimit nëse ka ende nevoja, të cilat nuk janë adresuar.

Zonja Strakosha, fjala për ju.

Pranvera Strakosha – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Shkurtimisht, pasi nuk dua t'ju marr shumë kohë, do t'ju paraqes një propozimin për disa shtesa në buxhet, i cili ka lidhje me shtesat në strukturë. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është një institucion i ri i krijuar në vitin 2014. Fillimisht ka pasur një strukturë të thjeshtë vetëm me 30 persona, pasi nuk dinim as volumin e punës, si do të ecte puna dhe sa kohë do të na merrte. Në këto 7 vjet të veprimtarisë sonë janë shtuar shumë problematikat dhe punë, pasi kemi detyra të lëna nga Kuvendi, monitorimin e të gjitha institucioneve dhe mbikëqyrjet në lidhje me zbatimin e të gjitha instituteve të ligjit. Interpretime dhe udhëzime të ndryshme që lëshohen për institucionet në bazë të kërkesave të tyre, duhet të ndjekin vendimet paralajmëruese të komisionerit pas një afati të përcaktuar kohor që ne vendosim. Pra, për shkak

të burimeve të kufizuara njerëzore që kemi nuk jemi të gjendje të shkojmë menjëherë në subjekt për të verifikuar nëse janë zbatuar, por komunikimet i kemi në rrugë elektronike dhe postare.

Kjo ka bërë të mundur, gjë, që e kemi konstatuar kur kemi vajtur në subjekt, që informacionet që kanë ardhur kanë qenë të cungura, të mangëta, si dhe kemi krijuar dhe gjetur problematika e të tjera. Ndërkohë, një detyrë, të cilën kemi 3 vjet që po e ndjekim nga Kuvendi, është zbatimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Në fakt, që kur kjo gjë na u caktua nga Kuvendi kemi krijuar një databazë, ku kemi marrë të dhënat dhe kemi konstatuar se kishte vendime gjyqësore që ishin të paekzekutuara që nga viti 2006 dhe këto i kemi raportuar në mënyrë periodike pranë jush.

Po ashtu, ka shumë problematika, të cilat i kemi ngritur, si dhe jemi duke ndjekur komisionet që janë ngritur pranë çdo institucioni, sepse nuk ishin ngritur në zbatim të udhëzimeve që kanë dalë, si dhe i kemi thirrur në seanca dëgjimore, por kjo është një problematikë që duhet ta ndjekin në vijimësi, pasi një pjesë e vendimeve ekzekutohen, ndërsa për pjesën tjetër rilindin ose vijnë vendime të formës së prerë.

Kemi konstatuar edhe problematika të tjera, kjo është jashtë buxhetit, duke i ngritur pranë KLSH-së dhe jush, siç është rasti kur kemi konstatuar që nëpunës civilë, të cilët kishin një vendim dhe prisnin të emëroheshin, paguheshin me dy paga, duke ndërhyrë dhe rekomanduar që të bëheshin kërkesa në gjykatë, sepse këta vijnë nëpërmjet përmbarimit, që të mos merrnin dy paga njëkohësisht ose të merrnin minimalisht diferencën e pagës që merrnin në pozicionin që ishin kur kanë fituar gjyqin me pozicionet e tjera.

Megjithatë, ekzekutimi i vendimeve ka edhe problematika, të cilat kërkojnë ndryshime ligjore, kështu që nuk po i parashtroj. Në fakt, do të doja të paraqisja para jush, jo sot (nëse do ta miratonit dhe ta shihnit të arsyeshme), pasi ka lindur nevoja e krijimit të një drejtorie. Ne sot kemi vetëm 12 inspektorë të ndarë në 4 drejtori, Drejtoria e Mbikëqyrjes, me 6 specialistë, Drejtoria e Hetimit Administrativ, 6 specialistë, Drejtoria Juridike me 4 specialistë dhe një Drejtori të Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët merren me raportimin, ku një ndër më kryesorët janë prioritetet e integritetit, me gjithë problematikën ligjore, si dhe oponencën që vjen nga institucione të ndryshme. Ne kemi menduar të krijojmë një drejtori për ekzekutimin e vendimeve qoftë gjyqësore, qoftë të Komisionerit, e cila do të jetë e përbërë nga 6 persona, 1 drejtor dhe 5 inspektorë, nëse ju do ta quani të arsyeshme.

Në fakt, impakti në buxhet është rreth 9 milionë lekë në vit. Kjo është kërkesa që ne kemi, të cilën nuk jua kemi sjellë, e kemi filluar si procedurë, pasi në progres-raportet që kanë ardhur që nga viti 2018 është folur gjithmonë për rritjen e kapaciteteve, ku rritja e kapaciteteve

të komisionerit është lënë si detyrë, në fakt, ne e kemi sjellë 2-3 herë kërkesën dhe nuk na është miratuar, kështu që edhe këtë vit ju sjellim të njëjtën kërkesë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zonja Strakosha, kërkesat tuaja në lidhje me buxhetin kanë të bëjnë vetëm një shtesë të numrit të stafit sa i takon mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Në fakt, kjo është një detyrë që është lënë 3 vjet më parë nga ky komision, unë kam ngulur këmbë atëherë, sepse ka qenë një situatë ku shumë vendime gjyqësore të formës së prerë për ish-nëpunës civilë nuk ekzekutoheshin, ndërkohë që buxheti i shtetit paguante për një vend pune dy veta, por nga veprimtaria juaj doli që paguheshin edhe tre, sepse një ish-punonjës i shërbimit civil punonte edhe në një institucion tjetër të shtetit jo me status dhe merrte edhe një rrogë tjetër atje, një shpërblim për efekt të gjyqit të fituar dhe tjetri ishte ai që kishte zënë vendin, pra një efekt buxhetor që do të duhej të rakordohej.

Më vjen mirë që e keni krijuar këtë praktikë pune, e cila ka qenë që në vitin 2006 për t'u monitoruar, por e rëndësishme është që ka vazhduar si proces dhe duhet të vijoj. Mendoj që shtesën që ju kërkoni, se e keni të bazuar në argumente, por dua të kuptoj nga Ministria e Financave lidhur me këtë kërkesë, nëse është marrë në konsideratë apo jo dhe pse.

Pranvera Strakosha - Faleminderit!

Lidhur me kërkesën e paraqitur nga Komisioneri, nga ana jonë është vlerësuar dhe nuk është marrë në konsideratë plotësisht numri i kërkuar, por një shtesë për vetëm 2 persona, së bashku me burimet e tjera financiare, në plotësim të kërkesës së strukturës së re. Nëse nga ana juaj do të vlerësohet që numri të shtohet me 2 të tjerë, në parim jemi dakord. Do të shikojmë vetëm nëse mund të kemi një ndryshim në burimet financiare të miratuara, nëse është e mundur, meqenëse burimet financiare në investime nuk janë përdorur në vitin 2021 dhe nëse nuk parashikohet që ju t'i shpenzoni përsëri në vitin 2022 një fond prej 2 milionë lekësh i miratuar në investime, të mund ta riallokojmë te shpenzimet “Për pagat dhe sigurimet”, me qëllim që ta plotësojmë edhe me burime financiare shtesën e kërkuar për dy punonjës të tjerë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zoti Bllako.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pranvera Strakosha – Nuk kam problem, jam dakord. Për investimet nuk është se kam nevojë për vitin që vjen, thjesht na duhen materialet e nevojshme të veprimtarisë së përditshme.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Strakosha!

Zoti Bllako.

Alqi Bllako – Faleminderit, kryetare!

Së pari, kisha një koment, pasi e kemi përsëritur disa herë në relatimet gjatë dëgjësive me institucionet, duhet të ketë një qasje nga Ministria e Financave, pra në rastet kur këtyre institucioneve u shtohen detyrat dhe përgjegjësitë, pa diskutim që këto shtesa duhet të shoqërohen edhe me efekte buxhetore, pasi në të kundërt është e pamundur të përmbushen.

Sa i përket propozimit, edhe unë e gjykoj një propozim të arsyeshëm. Mendoj se nga realizimi i buxhetit për vitin 2021, nëse do ta analizonim, do të shikonim që ka hapësira për rialokime si nga zëri i investimeve, ashtu edhe nga zëri i shpenzimeve për mallra dhe shërbime, pasi rezulton një nivel realizimi deri diku i ulët, aq më tepër që parashikimi i vitit 2022 është në rritje për këtë zë buxhetor. Ndaj, mendoj se mund të krijohet hapësirat e nevojshme për t'i bërë rialokimet brenda tavaneve për të përmbushur shtesën në strukturë.

Megjithatë, mendoj se para se të buxhetojmë, sërish duhet të ketë një vendim të këtij komisioni për shtesën e këtij numri, që më pas të shoqërohet me efektet buxhetore.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Me sa shoh propozimi është që të bëhet sërish një rialokim brenda zërave të buxhetit për këtë shtesë.

Dakord, diskutojeni këtë gjë në kuadrin e rregullave buxhetorë. Kam përshtypjen se nuk është njësoj situata si në fillim “miratim strukture”, është ndryshe në këtë rast, gjithsesi duhet ta qartësoni këtë gjë derisa të vijë momenti i miratimit nen për nen dhe në tërësi të buxhetit.

Kemi ndonjë koment nga kolegët?

Zoti Alibeaj, keni pyetje?

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit!

Në parim me institucionet që kanë pavarësi apo autonomi, siç jeni edhe ju, besoj se rregulli duhet të jetë: “Në bazë të performancës edhe mbështetja financiare”, apo jo. “Performo më mirë sesa në vitin paraardhës, merr më shumë para në vitin pasardhës sesa në vitin paraardhës”. Pra, financë në bazë të performancës.

Ky do të ishte një rregull që edhe ju besoj do të duhet ta bëni tuajin, apo edhe kur të prezantoheni në Kuvend, në Komisionin e Ligjeve ta sillni.

Gjëja e parë që do të doja të dëgjoja unë do të ishte: “Të nderuar deputetë, këtë vit kam bërë 1, 2, 3, 4 gjëra me lekët që më dhatë dhe i kam bërë mirë dhe në mënyrë cilësore. Për të bërë më shumë më duhen 1, 2, 3, 4, 5, 6.”. Pyetja që kam në këtë kuadër është: ju jeni të kënaqur me buxhetin? Kjo është një gjë që ngelet në analet dokumentare të këtij parlamenti, megjithatë kam një pyetje: kanë ndodhur ngjarje që e prekin shumë shërbimin civil, këtë vit

sidomos, e kuptoni që bëhet fjalë për zgjedhjet. Do të thotë (ka pretendime) që nëpunësit civilë gjatë procesit zgjedhor janë angazhuar në veprimtari qartazi politiko-elektorale. Janë pretendime. A keni kryer ndonjë monitorim, ndonjë mbikëqyrje, keni ndonjë informacion ose jo dhe çfarë ju ka rezultuar? E para.

E dyta, a ka pasur të dhëna apo informacione nga ju që poste pune në institucione të ndryshme, të cilat do të duhet të ishin nën suazën e shërbimit civil, të jenë mbuluar me punësime të përkohshme, edhe kjo gjatë procesit elektorale? Ka lidhje me buxhetin, se dakord, zonja mund të thotë “s’kam pasur para ta bëj këtë gjë ose kam pasur njerëz dhe para dhe e kam bërë dhe ky është rezultati. Kaq e thjeshtë është.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zonja Strakosha.

Pranvera Strakosha – Është hera e tretë këtë vit që kemi monitoruar sjelljen e nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore. Është një eksperiencë e re, që Komisioneri e filloi në vitin 2017, me zgjedhjet e përgjithshme, e kaloi te zgjedhjet vendore dhe më pas te zgjedhjet e përgjithshme. Ne kemi operuar me nxjerrjen e udhëzimeve, orientimeve dhe me ngritjen e grupeve. Pra Komisioneri dy-tre muaj para datës së zgjedhjeve ka kërkuar nga çdo institucion ngritjen e grupeve të monitorimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, pra ato 35 ditë të fushatës, ata kanë raportuar çdo ditë pranë Komisionerit, duke bërë apelin dhe kontrollet 3 herë në ditë. Pra, kjo ishte e vetmja formë se si mund t’i monitoronim ne të gjitha institucionet. Çdo institucion kishte nxjerrë rregulloren e vet, sipas modelit që i kemi çuar. Unë kam sjellë edhe një raport në Kuvend dhe e përmenda këtë gjë, kjo është një eksperiencë, ku kemi konstatuar edhe mungesat pa arsye. Në përfundim të fushatës, pas zgjedhjeve, kemi nxjerrë nga raportimet ditore edhe mungesat e pajustificuara dhe kemi kërkuar të na thonë se ku kanë qenë këta persona, nëse nuk kanë qenë në punë, edhe nëse nuk është vërtetuar që nuk kanë qenë në fushatë, të merren masa. Pra, i kemi ndjekur në vijimësi.

Për sa u përket emërimeve (dalin tani në një statistikë) i kemi kërkuar të na raportojnë të gjitha emërimet që kanë bërë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po e bëj politike!

Nuk intimidohem, zoti Alibeaj, nuk kam problem fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I kemi verifikuar dhe jemi duke i verifikuar.

Për sa i përket sjelljes dhe njoftimeve që kemi pasur (kemi kërkuar edhe nga KQZ-ja dhe na i kanë sjellë) kemi konstatuar që disa persona që kishin marrë pjesë në fushatë nuk

ishin në pozicionet e shërbimit civil. Që nga ky moment Komisioneri nuk ka më kompetencë të ndërhyjë.

Enkelejd Alibeaj – Kisha edhe një pyetje të fundit, që ka lidhje me buxhetin, me kapacitetet e institucionit për të çuar para veprimtarinë. Një nga çështjet që besoj se ka tërhequr vëmendjen e gjithë publikut është fakti (ka gjithmonë pretendime, kjo do të dalë në fund) që shumë prej nëpunësve civilë që janë në suazën e shërbimit civil, përgjatë fushatës, gjithmonë, kanë kryer edhe një veprimtari tjetër, atë të patronazhistëve.

Ju rezulton kjo?

Pranvera Strakosha – Verifikojmë sjelljen e nëpunësve civilë gjatë orarit të punës, që do të thotë se ne kemi nxjerrë edhe një udhëzim dhe neni 37 i ligjit kërkon që ata në momentin që janë në orarin e punës nuk mund të marrin pjesë, dhe jashtë orarit të punës ata janë të lirë të marrin pjesë në fushatë apo takime elektorale, por nuk kanë të drejtë të shprehen publikisht. Nuk mund të flasin në publik, por mund të marrin pjesë dhe të dëgjojnë alternativat që ata mendojnë. Ne kemi nxjerrë edhe një udhëzim dhe, në fakt, njëkohësisht në të njëjtën linjë ishte edhe KQZ-ja që ka nxjerrë aktet e veta.

Unë nuk e di çfarë është patronazhisti, mua nuk më rezulton si funksioni i nëpunësit civil, por shoh vetëm pjesën e nëpunësit civil gjatë orarit të punës dhe nëse ndonjë nga këta del dhe flet nëpër mitingje dhe mua më vjen një njoftim i tillë, atëherë fillojmë hetimin administrativ dhe konstatojmë se ka shkelur ligjin.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Strakosha!

Ju, në fakt, keni sjellë një raport në Kuvend pas zgjedhjeve në këtë komision. Ju kemi dëgjuar, ju kemi falënderuar për punën, sepse, në fakt, ky shtet dhe këto institucione kanë ligje, rregulla dhe raportime. Ne përpiqemi ta vazhdojmë një histori sa herë na jepet mundësia të flasim për ato që kemi disa ditë që po i diskutojmë në një komision hetimor të Kuvendit dhe po përdorim në çdo moment të çdo mbledhjeje të komisioni të njëjtat tema, ndërkohë që këtu ju kishim ftuar për buxhetin për t'ju pyetur nëse i ushtronit dot funksionet tuaja me këto tavane buxhetore që ju jep Ministria e Financave. Ju e sqaruat që keni rakorduar tashmë me Ministrinë e Financave dhe ndërkohë për çështjet e punonjësve shtesë sa u takon punonjësve, të cilët duhen në kuadër të monitorimit të ekzekutimeve të vendimeve të gjykatave për nëpunësit civilë, mendoj që, siç e diskutuam me Ministrinë e Financave dhe relatorin, duhet të bëni një saktësim për alokim të brendshëm, pra jo rritje të buxhetit të institucionit, por alokim të fondeve së brendshmi.

Këtë gjë duhet ta sqaroni saktë, zonja Strakosha, me ministrinë dhe relatorin, në mënyrë që të adresohet siç duhet, sepse javën tjetër duhet të kalojmë buxhetin nen për nen dhe në tërësi.

Unë ju falënderoj kolegë, për durimin!

Ju falënderoj zonja Strakosha, që ishit e pranishme!

Këtu e mbyllim mbledhjen. Ju kujtoj mbledhjen e përbashkët të orës 14:30 të Këshillit të Legjislacionit dhe Komisionit të Ligjeve.

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA